



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 649/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.10.2019 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-30470-07-16-2019, me objekt “Riparim dhe mirembajtje automjete”, me fond limit 2.499.500 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 12.08.2019, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal, Fier.

Ankimues: “Alstezo” sh.a.
Lagja “Kryengritja e Fierit”, Rruga “Aulona”, Fier

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Spitalit Rajonal, Fier
Lagja “1 Maj”, Rruga “Invalidët e Luftës”, Fier

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 17.07.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-30470-07-16-2019, me objekt “*Riparim dhe mirembajtje automjete*”, me fond limit 2.499.500 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 12.08.2019, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal, Fier.

II.2. Në datën 22.07.2019, operatori ekonomik ankimues “Alstezo” sh.a., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e kriterëve të kualifikimit. Në ankesë pretendohet si më poshtë vijon:

[...]Sa me lart referuar, ankesa jone eshte brenda afateve ligjore te percaktuara ne legjislacionin perkatese pasi ne daten 17.07.2019 eshte bere publikimi i kesaj procedure prokurimi dhe sot me date 22.07.2019, brenda afatit 7 ditor nga publikimi i saj po paraqesim ankese prane Autoritetit Kontraktor. Shoqeria jone legjitimohet per te paraqitur ankese pasi ka interes per kete procedure prokurimi. Nga publikimi i ketyre dokumentave dhe nga shqyrtimi i tyre kemi verejtur se ato

perbehen nga kritere qe nuk jane hartuar ne perputhje me legjislacionin dhe rregullat per prokurimit publik dhe vijne ne kundërshtim me to pasi jane diskriminuëse, përjashtuese dhe jo ne përpjesëtim me natyrën dhe objektin e prokurimit. Pasi jemi njohur me Kriteret e Vecanta per Kualifikim, vlerësojme se nuk jane ne perputhje me Ligji Nr.9643 dt 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar nenin I, 2, 23 e ne vijim, si dhe V.K. M. Nr 914, dt. 29/12/2014 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" i ndryshuar, Nenin 28, kerkojme ndryshimin e tyre me arsyetimin, si vijon:

Ne kerkesat e Vecanta te Kualifikimit, ne Kapacitetin Teknik, jane kerkuar:

“2.3.4 Operatori ekonomik duhet te kete minimalist, pajise teknik te nevojshme bashkekohore per realizimin e kontrates, si vijon:

-Jo me pak se 2(dy) ura ngritese per automjete me kapacitet jo me pak se 3.5 ton

-Pajisje per kontrollin dhe testimin (diagnostikimin) e sistemit elektrik dhe difekteve ne motor te Automjetit.

-Pajisje per cmontimin dhe montimin e gomave ne diskun e rrotes se automjetit

-Pajisje per kontrollin&balancimin e disqeve dhe gomave automjetit (ballancimi rrotave

-Pajisje per kontrollin dhe realizimin e gjeometrise (konvergjence) rrotave te mjetit

-Pajisje per kontrollin dhe mbushje me gaz te Sistema A/C

Ne nenin 23 të LPP, të ndryshuar parashikohet [...]

Ne nenin 28 të VKM 914, datë 29.12.2014, I ndryshuar parashikohet [...].

Pra autoriteti kontraktor eshte ne te drejten e tij per te kerkuar deshmi per mjetet por per mjetet qe nevojiten per kryerjen e ketij sherbimi duke i percaktuar ato ne perputhje me zerat e sherbimit qe do te kryhen dhe duke percaktuar mjete e pajisje qe nuk mbulojne te gjithë zerat e riparimit dhe mirembajtjes te kerkuara ne lidhje me kete procedure prokurimi. Sa me siper lidhur me Urat ngritese jane kerkuar me kapacitet deri ne 3.5 ton, nderkohe qe ambulancat e Spitalit duke kalkuluar peshembajtje edhe me pajisjet spitalore te montuara mbi to, shkojne deri ne kapacitetin mbi 3.5-4 ton, pra ky kriter duhet te rishikohet duke u bere ne raport me peshën e mjeteve qe do riparohen.

Duke pare zerat e sherbimeve qe do te kryhen per riparimet e mjeteve, objekt i ketij prokurimi rezulton se autoriteti kontraktor ka kerkuar qe operatorët ekonomike te interesuar per te marre pjese ne kete procedure prokurimi per te vertetuar se disponojne kapacitetet e duhura ne lidhje me mjetet ka percaktuar vetem pajisje te tilla per riparimin dhe mirembajtjen e gomave, apo disqeve te gomave, pajisje keto te cilat nuk sherbejne per mbulimin e te gjitha sherbimeve te kerkuara nga autoriteti kontraktor per kete objekt prokurimi, te percaktuara keto ne Shtojcen 8 te DST. Nisur nga zerat e sherbimit per riparimin dhe mirembajtjen e automjeteve rezulton se ka shume sherbime te cilat nuk mbulohen nga pajisjet qe ka kerkuar autoriteti kontraktor, pra autoriteti kontraktor bazuar ne parimet dhe qellimet e ligjit per prokurimin publik per mosdiskriminimin, transparence dhe trajtimin e barabarte si edhe mireperdorimin e fondeve publike, duhet te percaktoje kritere me qellim verifikimin nese nje operator ekonomik disponon te gjitha kapacitetet e duhura per kryerjen me sukses te ketij sherbimi aq me teper kur kemi te bejme me sherbim te riparimit dhe mirembajtjes se automjeteve te Spitalit Fier, mjete keto te cilat kane te bejne edhe me nje interes publik te madh sic eshte jeta e qytetareve, pasi kemi te bejme me mjete autoambulanca etj. Per keto arsye autoriteti kontraktor nuk mund te percaktoje kritere te cilat mbulojne apo perfshijne vetem disa sherbime te mjeteve te percaktuara ne dst duke lene jashte nje

pjese te mire te funksioneve te tyre si edhe duke mos perur aftesine teknik te domosdoshme qe detyrimisht duhet ta kete cdo operator ekonomik i interesuar per te qene pjesemarres ne kete procedure. Autoriteti kontraktor nuk mundet te kerkoje pajisje vetem per gomat apo disqet e gomave pasi vetem keto pajisje nuk mund te kryejne sherbimet e riparimeve qe jane percaktuar nga vete autoriteti kontraktor ne DST te tilla sic jane linja e kontrollit dhe diagnostikimit te difekteve jo vetem ne motor (te rendesishme si procese pune te sherbimeve te kerkuara nga Ak ne DST) linje kjo e cila ka pajisje shume te rendesishme dhe pa te cilat nuk mund te kryhet riparimi dhe mirembajtja, kontrolli dhe diagnostikimi i gjendjes teknik xherike te mjeteve te kerkuara ne DST para dhe pas riparimit.

Konkretisht sherbimet ne lidhje me kontrollin e sistemit te frenimit te mjetit, kontrolli ne lidhje me sistemin e amortizimit te mjetit, kontrolli i sistemit te drejtimit te mjetit (xhokove etj) si edhe sherbime te tjera te permendura dhe listuara nga autoriteti kontraktor ne dokumentat e tenderit, nuk mund te behen me pajisjet per gomat apo disqet e gomave. Autoriteti kontraktor duhet te percaktojte kriteret ne perputhje dhe perpjesetim me natyren dhe permasat e kontrates objekt prokurimi dhe ne perputhje me zerat e sherbimit te kerkuar rrjedhimisht duhet te percaktojte edhe kriteret per pajisjet qe nje operator ekonomik disponon ose mund te disponoje ne lidhje me kryerjen e ketij sherbimi me qellim verifikimin nese ky operator disponon te gjitha mjetet e duhura dhe te rendesishme per kryerjen e nje sere sherbimesh te domosdoshme ne lidhje me mjetet qe autoriteti kontraktor ka percaktuar ne dokumentat e tenderit. Ne dokumentat e tenderit objekti i ketij prokurimi nuk eshte vetem sherbimi i riparimit dhe mirembajtjes se gomave apo disqeve te gomave, por jane percaktuar edhe shume sherbime te tjera shume me te rendesishme qe lidhen me mirembajtjen dhe riparimin e automjeteve.

Procesi i kontrollit dhe riparimit eshte nje proces kyc dhe shume i rendesishem ne riparimin dhe mirembajtjen e mjeteve, qe ne kete rast eshte dhe objekti i prokurimit te publikuar nga autoriteti kontraktor Spitali Fier, dhe ky proces i pare edhe nga zerat e sherbimit qe ka publikuar Spitali Fier, kerkon qe nje OE te jete i afte teknikisht per te kryer keto sherbime dhe per te perballuar keto sherbime riparime dhe kontrolli per realizimin teknikisht te ketyre sherbime qe do te thote perballimin per realizimin si nga ana profesionale pra te kete punonjesit dhe profesionistet e duhur por ashtu edhe nga ana e disponimit te mjeteve te duhura te domosdoshme e te nevojshme per kryerjen e ketij sherbimi, ku futet ana tjeter - ajo e pajisjeve qe nje OE ka ne dispozicion per te mbuluar te gjitha zerat e sherbimit te kerkuar nga autoriteti kontraktor ne dokumentat e tenderit. Edhe Komisioni i Prokurimit Publik ne raste te tilla te ngjashme ka mbajtur te njejtin qendrim ndaj autoriteti kontraktor duhet te beje modifikimet e duhura ne perputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit si edhe me natyren e ketij sherbimi dhe kesaj procedure prokurimi.

Sic thame dhe me lart dukshem ne linjen e kontrollit dhe diagnostikimit te difekteve, eshte hequr me qellim pajisjet shume te rendesishme pa te cilat nuk mund te kryhet kontrolli i gjendjes teknik te mjetit para dhe pas riparimit, sikurse jane:

Pajisje per sistemin e kontrollit te frenimit te mjetit

Pajisje per sistemin e kontrollit te amortizimit te mjetit

Pajisje per kontrollin e sistemit te drejtimit te mjetit (xhokove etj)

Perfundimisht, kerkoime qe AK te beje ndryshimet e mesiperme ne KVK e DT, duke perfshire pajisjet e mesiperme te domosdoshme per kryerjen e ketij sherbimi dhe realizimin me sukes te kesaj kontrate ne rast shpallje fitues.

II.3. Referuar ankesës së dorëzuar nga operatori ekonomik ankimes, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe dokumentacionit bashkëlidhur saj, konstatohet se, autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.3189 prot., datë 24.07.2019 i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik “Alstezo” sh.a. duke e refuzuar atë. Operatori ekonomik ankimes në ankesën e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik, pretendon se ka marrë dijëni në lidhje me kthimin e përgjigjes së ankesës së tij nga ana e autoritetit kontraktor, në datë 29.07.2019, duke paraqitur zarfin postar të shkresës së mësipërme. Konkretisht, autoriteti kontraktor në kthim përgjigje ka argumentuar:

[...]Autoriteti Kontraktor Spitali Rajonal Fier pasi analizoi me kujdes ankesën e operatorit ekonomik "Alstezo" sh.a Fier arsyeton se:

Fillimisht sqarojme se për ta mbështetur pretendimin e tij, ankimesi duhet të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicje dhe argumenta ose dokumentacionin përkatës, në bazë të cilave do të shqyrtohej pretendimi i tij se “...specifikimet teknike janë të kushtëzuara dhe të kufizuara për OE (një kompani) duke përjashtuar mundësinë e pjesëmarrjes dhe të OE të tjerë.”

Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon këtë pretendim të tij dhe jo të shprehë vetëm supozimet e veta në mënyrë argumentuar, si dhe të evidentojë qartë dhe saktë se në çfarë argumentash dhe provash e bazon pretendimin e tij. Në rastin konkret ankimesi ka ngritur një pretendim abstrakt, pa argumente të arsyeshme apo indicje të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementeve përbërës të specifikimeve teknike që ai kundërshton. Megjithatë me qëllim hapjen maksimalisht të garës dhe realizimin sa më të mirë të konkurrencës, Spitali Fier do të trajtojë si vijon të gjitha kërkesat e parashtuara nga ankimesi:

a Operatori ekonomik "Alstezo" sh.a Fier ka kërkuar modifikimin e specifikimeve teknike të përcaktuara në Shtojcën nr 7 të DST Kriteret e vecanta të kualifikimit përkatës:

I. Në Shtojcën nr7 të DST Kriteret e vecanta të kualifikimit nën titullin Për kapacitetin teknik: pika 2.3.4

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht, paisje teknike të nevojshme bashkëkohore për realizimin e kontratës, si vijon:

- Jo më pak se 2 (dy) ura ngritese për automjete me kapacitet jo më pak se 3.5 ton*
- Paisje për kontrollin dhe testimin (diagnostikimin) e sistemit elektrik dhe defekteve në motorin e automjetit.*
- Paisje për zmontimin dhe montimin e gomave në diskun e rrotës së automjetit.*
- Paisje për kontrollin & balancimin e disqeve & gomave të automjetit (ballancimi i rrotave).*
- Paisje për kontrollin dhe realizimin e gjeometrise (konvergjencës) të rrotave të mjetit.*
- Paisje për kontrollin dhe mbushje me gaz të sistemit A/C*

Në lidhje me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

Dokumenta që vërtetojnë se këto mjete apo pajisje i ka në pronësi (të paraqitet fatura blerje brenda vendit, ndërsa në rastet e blerjes jashtë vendit, faturat e blerjes të jenë të shoqëruar me dokument çdoganimit të tyre në emër të shoqërisë) ose për pajisjet dhe mjetet e marra me qira të paraqitet kontrata e qirës e cila duhet të jetë e vlefshme për periudhën e realizimit të kontratës

-Operatori ekonomik Alstezo sh.a Fier pretendon se Urat ngritese janë kërkuar me kapacitet deri në 3.5 ton ndërkohë që ambulancat e spitalit duke i kalkuluar peshembajtje dhe me paisjet spitalore

te montuara mbi to shkojne deri ne kapacitetin mbi 3.5 ton pra ky kriter duhet te rishikohet duke u bere ne raport me peshen e mjeteve qe do te riparohen.

Pas shqyrtimit te ankeses AK arriti ne konkluzionin se ky pretendimi OE "Alstezo" sh.a. Fier nuk qendron per arsye se urat ngritese jane kerkuar me kapacitet jo me pak se 3.5 ton dhe jo deri ne 3.5 ton sic pretendohet nga OE "Alstezo" sh.a. Fier dhe eshte ne perputhje te plote me peshen e automjeteve perfshire dhe pajisjet spitalore te cilat jane montuar mbi to. Ankesa lidhur me kete pike nuk pranohet.

2. Ne Shtojcen nr 7 te DST Kriteret e vecanta te kualifikimit nen titullin Per kapacitetin teknik: pika 2.3.4

2.3.4 Operatori ekonomik duhet te kete minimalisht, paisje teknike te nevojshme bashkekohore per realizimin e kontrates, si vijon:

- Jo me pak se 2 (dy) ura ngritese per automjete me kapacitet jo me pak se 3.5 ton
- Pajisje për kontrollin dhe testimin (diagnostikimin) e sistemit elektrik dhe difekteve në motorr të automjetit.
- Paisje per zmontimin dhe montimin e gomave ne diskun e rrotes se automjetit.
- Paisje per kontrollin&balancimin e disqeve&gomave automjetit (ballancimi rrotave).
- Paisje per kontrollin dhe realizimin e gjeometrise (konvergjences) rrotave te mjetit.
- Pajisje per kontrollin dhe mbushje me gaz te sistemit A/C

Ne lidhje me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese:

Dokumenta qe vertetojne se keto mjete apo pajisje i ka ne pronesi (te paraqitet fature blerje brenda vendit, ndersa ne rastet e blerjes jashte vendit, faturat e blerjes te jene te shoqeruar me dokument çdoganimi te tyre ne emer te shoqerise) ose per pajisjet dhe mjetet e marra me qira te paraqitet kontrata e qirase e cila duhet te jete e vlefshme per periudhen e realizimit te kontrates

Operatori ekonomik "Alstezo" sh.a Fier kerkon qe ky kriter te modifikohet si me poshte:

2.3.4 Operatori ekonomik duhet te kete minimalisht, paisje teknike te nevojshme bashkekohore per realizimin e kontrates, si vijon:

- Jo me pak se 2 (dy) ura ngritese per automjete me kapacitet jo me pak se 3.5 ton
- Pajisje për kontrollin dhe testimin (diagnostikimin) e sistemit elektrik dhe difekteve në motorr të automjetit.
- Paisje per zmontimin dhe montimin e gomave ne diskun e rrotes se automjetit.
- Paisje per kontrollin&balancimin e disqeve&gomave automjetit (ballancimi rrotave).
- Paisje per kontrollin dhe realizimin e gjeometrise (konvergjences) rrotave te mjetit.
- Pajisje per kontrollin dhe mbushje me gaz te sistemit A/C
- Pajisje per frenimin e mjetit
- Pajisje per sistemin e kontrollit te amortizimit te mjetit
- Pajisje per kontrollin e sistemit te drejtimit te mjetit (xhokove etj)

Pas shqyrtimit të ankeses AK arriti ne konkluzionin se ky pretendim i OE "Alstezo" sh.a Fier nuk qendron per arsye se operatori ekonomik "Alstezo" sh.a. Fier kerkon shtim kriteresh gje e cila nuk I sherben realizimit te kontrates pasi defektet jane tashme te konstatuara dhe nuk perfshihen ne sherbimet e kerkuara pra nuk eshte kerkuar control e sistemit te frenimit, kontroll i amortizimit te mjetit apo kontroll i sistemit te drejtimit te mjetit (xhokove...etj). Ankesa lidhut me kete pike nuk pranohet.

Kriteret e vendosura ne kete pike jane kritere minimale dhe aspak diskriminuese por u jep mundesi dhe ofron alternative per pjesemarrjen e nje numri sa me te gjere operatoresh ekonomike ne kete procedure.

KVO: Seti I DST ne kete procedure eshte monitoruar dhe nga Njesia e Koordinimit prane APP-se e cila ka dhene rekomandimet perkatese te cilat jane pasqyruar ne SPE nepermjet shtojces nr.1 dhe kjo pike per te cilen ankimon operatori ekonomik "Alstezo" sh.a Fier nuk eshte gjetur ne kundërshtim me ligjin apo te kishte paqartesi ose mangesi lidhur me kriteret e vendosura.

Per sa me siper pretendimet e operatorit ekonomik "Alstezo" sh.a. Fier nuk qendrojnë dhe nuk merren parasysh pra ankesa nuk pranohet.

II.4. Në datën 26.07.2019, operatori ekonomik ankimues "Alstezo" sh.a., ka paraqitur përsëri ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke ngritur pretendime mbi shtojcën e publikuar nga autoriteti kontraktor për modifikimin e dokumentave të tenderit. Në ankesë operatori ekonomik ankimues pretendon si më poshtë vijon:

Sa me lart referuar, ankesa jone është brenda afateve ligjore të përcaktuara ne legjislacionin perkates pasi ne daten 25.07.2019 eshte bere publikimi i shtojces se kesaj procedure prokurimi dhe sot me date 26.07.2019, brenda afatit 7 ditor nga publikimi i saj po paraqesim ankese prane Autoritetit Kontraktor. Kjo procedure prokurimi eshte publikuar ne daten 17.07.2019 dhe ne daten 22.07.2019 paraqitem ankese prane ketij autoriteti per modifikimin e kriterëve per kualifikim te cilat ishin hartuar ne kundërshtim me ligjin.

Ne daten 25.07.2019 autoriteti kontraktor jo vetem qe nuk ka marre parasysh ankesen tone dhe nuk na ka kthyer pergjigje po ka publikuar ne sistem nje shtojce ku ka modifikuar kriteret dhe shohim qe edhe modifikimi i tyre, i cili eshte bere jo per pretendimet qe kemi ngritur ne si shoqeri, por per kritere te tjera ka perseri probleme, pasi edhe modifikimi i kriterëve eshte bere ne kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik. Shoqëria jone legjitimohet per te paraqitur ankese, pasi ka interes per kete procedure prokurimi.

Keto ndryshime perbehen nga kritere qe nuk jane hartuar ne perputhje me legjislacionin dhe rregullat per prokurimit publik dhe vijne ne kundërshtim me to, pasi jane diskriminuese, perjashtuese dhe jo ne perpjesetim me natyren dhe objektin e prokurimit. Pasi jemi njohur me Kriterëve te Vecanta per Kualifikim, vleresojme se nuk jane ne perputhje me Ligji Nr. 9643 dt 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 1, 2, 23 e ne vijim, si dhe VKM. Nr 914, dt. 29/12/2014 "PER MIRATIMIN E RREGULLAVE TE PROKURIMIT PUBLIK" i ndryshuar, Nenin 28, kerkojme ndryshimin e tyre me arsyetimin si vijon:

ne kundërshtojme modifikimin e bere pervec pjeses se kriterit ne teresi që kemi bërë në ankesën e pare dhe i qendrojmë ende.

I.Pas modifikimit ne Kerkesat e Vecanta te Kualifikimit, ne Kapacitetin Teknik, pika 2.3.4 eshte modifikuar si me poshte:

2.3.4 Operatori ekonomik duhet te kete minimalisht, paisje teknike te nevojshme bashkekohore per realizimin e kontrates, apo pajisje teknike që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën si vijon:

- Jo me pak se 2 (dy) ura ngritese per automjete me kapacitet jo me pak se 3.5 ton

- Pajisje për kontrollin dhe testimin (diagnostikimin) e sistemit elektrik dhe difekteve në motorr të automjetit.
- Pajisje për zmontimin dhe montimin e gomave në diskun e rrotës së automjetit.
- Pajisje për kontrollin & balancimin e disqeve & gomave të automjetit (ballancimi i rrotave).
- Pajisje për kontrollin dhe realizimin e gjeometrisë (konvergjencës) të rrotave të mjetit.
- Pajisje për kontrollin dhe mbushje me gaz të sistemit A/C

Ne lidhje me këto pike operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

□ Dokumenta që vërtetojnë se këto mjete apo pajisje i ka në pronësi (të paraqitet fatura blerje brenda vendit, ndërsa në rastet e blerjes jashtë vendit, faturat e blerjes të jenë të shoqëruar me dokument çdoganimi të tyre në emër të shoqërisë) ose për pajisjet dhe mjetet e marra me qira të paraqitet kontrata e qirase e cila duhet të jetë e vlefshme për periudhën e realizimit të kontratës

□ Në rastin e pajisjeve që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën duhet të paraqesë kontratën perkatese conform dispozitave të Kodit Civil ku të percaktohet disponueshmeria e pajisjeve dhe mjeteve të kërkuara për kryerjen e këtij shërbimi nga operatori ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë. Kontrata duhet të jetë e vlefshme për periudhën e realizimit të kontratës.

Në nenin 23 të ligjit nr 9643 datë 20. 11.2006 "Për prokurimin publik" të ndryshuar parashikohet se: [...].

Në nenin 28 të VKM 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ndryshuar, [...].

Pra autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të kërkuar dëshmi për mjetet, por për mjetet që nevojiten për kryerjen e këtij shërbimi duke i percaktuar ato në përputhje me zerat e shërbimit që do të kryhen dhe jo duke percaktuar mjete e pajisje që nuk mbulojnë të gjithë mërembajtjes të kërkuara në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

Në lidhje me percaktimin e bërë me paragrafin me "Bold", si vijon: "Në rastin e pajisjeve që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën duhet të paraqesë kontratën perkatese conform dispozitave të Kodit Civil ku të percaktohet disponueshmeria e pajisjeve dhe mjeteve të kërkuara për kryerjen e këtij shërbimi nga operatori ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë. Kontrata duhet të jetë e vlefshme për periudhën e realizimit të kontratës."

Sa me sipër, nuk kuptojmë se çfarë ka dashur të thotë autoriteti kontraktor dhe çfarë ka kërkuar në të vërtetë. Kriteri i hartuar kështu, ashtu siç percakton edhe KPP në vendimet e tij, është i paqartë konfuz, si për operatorin ekonomik dhe për vetë autoritetin kontraktor dhe kjo dhe nuk kuptohet qëllimi i vendosjes së këtij kriteri dhe çfarë kërkon të vërtetojë autoriteti kontraktor me një kriter të tillë, pasi nuk i shërben kësaj procedurë prokurimi dhe nuk është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kësaj procedurë prokurimi. Kërkojmë heqjen e këtij kriteri si kriter i teper, diskriminues dhe pa kuptim në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

II Në dokumentat e tenderit pas modifikimit në pikën 2.3.1 është vendosur kriter:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në safin e tij të punësuar të përhershëm ose me kontratë jo më pak se 5 (pese) punonjës mesatarisht për çdo muaj për periudhën Mars 2019- Maj 2019, nga të cilët në stafin teknik të jenë të punësuar përgjegjësin teknik/drejtuesi teknik, i cili duhet të jetë inxhinier mekanik ose teknik, mekanik transport, 1(një) pompist ose motorist, 2 (dy) xhenerike, 1 (një) elektroaut.

Ne lidhje me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese: Listepagesat e sigurimeve shogerore per periudhen (Mars 2019-Maj 2019) ku punonjesit me profesionet perkatese sa me siper te jene te pasqyruar perkatesisht ne keto lista si dhe Stafi i sipercituar duhet te kene eksperience minimalist 3 muaj pune ne profesionet perkatese te sipercituara vertetuar me dokumentacion te leshuar nga institucionet e autorizuar me ligj.

Edhe per kete kriter autoriteti kontraktor prape ka diskriminuar duke vendosur pa kuptim dhe pa lidhje me kete procedure prokurimi. Autoriteti kerkon qe keta punonjes te jene ne listepagese per periudhen Mars 2019-Maj 2019 si dhe kontratat e punes, per te vertetuar qe OE ka kapacitetet e duhura ne lidhje me stafin.

Me modifikimin e publikuar ne daten 25.07.2019 autoriteti kontraktor ka shtuar edhe kriterin: “Stafi i sipercituar duhet te kene eksperience minimalist 3 muaj pune ne profesionet perkatese te sipercituara vertetuar me dokumentacion te leshuar nga institucionet e autorizuar me ligj.

Ky shtim kriteri eshte i paqarte i pakuptimte dhe nuk kuptojme qellimin e AK pse e ka vendosur. AK kerkon qe stafi te kete eksperience minimalist 3 muaj pune ne profesionet perkatese dhe kerkon te vertetohet kjo me dokumentacion te leshuar nga institucionet e autorizuar. Ky percaktim eshte kontraktor dhe i paqarte sepse AK nuk ka percaktuar se kush jane institucionet e autorizuar me ligj qe leshojne nje dokument te tillë për profesionet me lart apo per eksperiencen 3 mujore që ka kërkuar AK, për më tepër që duket një kriter i tepërt e pa sens logjik.

AK per te vertetuar kapacitetet ne lidhje me stafin duhet te mjaftohet me listepagesat ku punonjesit me profesionet perkatese te jene te perfshire si edhe me kontratat e punes, si dhe deshmite profesionale te punonjesve. Kerkesa e shtuar ne modifikim eshte e tepert, diskriminuese, jo ne perpjesetim me objektin dhe natyren e prokurimit dhe si sherben aspak qellimit te AK per vertetimin e disponimit te kapaciteteve nga ana e OE.

Si perfundim kerkojme heqjen e ketij percaktimi si diskriminues e perjashtues duke kufizuar konkurrencen dhe pjesemarrjen ne procedure e prokurimit.

Perfundimisht, kerkojme qe AK te beje ndryshimet e mesiperme ne DST ne perputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik.

II.5. Referuar ankesës së dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe dokumentacionit bashkëlidhur saj, konstatohet se, autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.3256 prot., datë 29.07.2019 i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik “Alstezo” sh.a. duke e refuzuar atë. Operatori ekonomik ankimues në ankesën e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik, pretendon se ka marrë dijeni në lidhje me kthimin e përgjigjes së ankesës së tij nga ana e autoritetit kontraktor, në datë 30.07.2019, duke paraqitur zarfin postar të shkresës së mësipërme. Konkretisht, autoriteti kontraktor në kthim përgjigje ka argumentuar:

Autoriteti Kontraktor Spitali Rajonal Fier pasi analizoi me kujdes ankesen e operatorit ekonomik "Alstezo" sh.a Fier arsyeton se:

Fillimisht sqarojme se per ta mbeshtetur pretendimin e tij, ankimuesi duhet te kishte shoqeruar ankesen e tij me prova, indicje dhe argumenta ose dokumentacionin perkates, ne baze te te cilave do te shqyrtohej pretendimi i tij se “...specifikimet teknike jane te kushtezuara dhe te kufizuara per OE (nje kompani) duke perjashtuar mundesine e pjesemarrjes dhe te OE te tjere.” Operatori ekonomik ka detyrimin qe ta beje te identifikueshem pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar,

pra te evidentojte qarte dhe sakte se ku e bazon kete pretendim te tij dhe jo te shprehe vetem supozimet e veta ne menyre pargumentuar, si dhe te evidentojte qarte dhe sakte se ne cfare argumentash dhe provash e bazon pretendimin e tij. Ne rastin konkret ankimuesi ka ngritur nje pretendim abstrakt, pa argumente te arsyeshme apo indicie te qarta, mbi te gjitha specifikimet teknike qe ai kundërshton ngushtojne pjesmarrjen e nje numri sa me te madh te operatorëve ekonomik te interesuar.

a Operatori ekonomik "Alstezo" sh.a Fier ka kerkuar heqjen e dy kritereve te shtuara si pasoje e ankesave te paraqitura nga operatorët ekonomik me date 25.07.2019 ne Shtojcen nr 7 te DST Kriteret e vecanta te kualifikimit perkatesisht

I. Ne Shtojcen nr7 te DST Kriteret e vecanta te kualifikimit nen titullin Per kapacitetin teknik: pika 2.3.4

2.3.4 Operatori ekonomik duhet te kete minimalisht, paisje teknike te nevojshme bashkekohore per realizimin e kontrates, apo pajisje teknike qe mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën si vijon:

- Jo me pak se 2 (dy) ura ngritese per automjete me kapacitet jo me pak se 3.5 ton
- Pajisje për kontrollin dhe testimin (diagnostikimin) e sistemit elektrik dhe difekteve në motorr të automjetit.
- Paisje per zmontimin dhe montimin e gomave ne diskun e rrotes se automjetit.
- Paisje per kontrollin&balancimin e disqeve&gomave automjetit (ballancimi rrotave).
- Paisje per kontrollin dhe realizimin e gjeometrise (konvergjences) rrotave te mjetit.
- Pajisje per kontrollin dhe mbushje me gaz te sistemit A/C

Ne lidhje me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese:

☐ Dokumenta qe vertetojne se keto mjete apo pajisje i ka ne pronesi (te paraqitet fature blerje brenda vendit, ndersa ne rastet e blerjes jashte vendit, faturat e blerjes te jene te shoqeruar me dokument çdoganimit te tyre ne emer te shoqerise) ose per pajisjet dhe mjetet e marra me qira te paraqitet kontrata e qirase e cila duhet te jete e vlefshme per periudhen e realizimit te kontrates

☐ Ne rastin e pajisjeve qe mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën duhet te paraqese kontraten perkatese conform dispozitave te Kodit Civil ku te percaktohet disponueshmeria e pajisjeve dhe mjeteve te kerkuara per kryerjen e ketij sherbimi nga operatori ekonomik pjesmarres ne kete procedure. Kontrata duhet te jete e vlefshme per periudhen e realizimit te kontrates.

-Operatori ekonomik "Alstezo" sha Fier kerkon qe te hiqet paragrafi i fundit (shkrimi me bold)

Pas shqyrtimi të ankeses AK arriti ne konkluzionin se ky pretendim I oe "Alstezo" sh.a. Fier nuk qendron per arsye se paragrafi i fundit (pjesa me bold) eshte vendosur konform VKM nr.914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave per prokurimin publik" i ndryshuar, neni 28, pika 5 ku percaktohet se: "Per te provuar kapacitetet teknik dhe profesionale, autoriteti kontraktor kerkon: germa "c" deshmi per mjetet dhe pajisjet teknik qe ka ne dispozicion apo qe mund ti vihen ne dispozicion operatori ekonomik per te permbushur kontraten" dhe nenkupton qe nje operator ekonomik megjithese mund te mos I kete ne disponim keto pajisje (ne pronesi apo me qira) ne momentin e hapjes se procedures ai ne rast se shpallet fitues i ka te siguruara nepermjet nje kontrate me kusht apo kontrate porosie pas dispozitave perkatese te Kodit Civil. Gjithashtu vendosja e ketij kriteri mundeson hapjen maksimalisht te gares dhe realizimin sa me te mire te konkurences lidhur me proceduren objekt prokurimi

2. Ne Shtojcen nr 7 te DST Kriteret e vecanta te kualifikimit nen titullin Per kapacitetin teknik: pika 2.3.1

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete ne statin e tij te punesuar te perhershëm ose me kontrate jo me pak se 5 (pese) punonjes mesatarisht per cdo muaj per periudhen Mars 2019- Maj 2019, nga te cilet ne stafin teknik te jene te punesuar pergjegjesin teknik/drejtuesi teknik, i cili duhet te jete inxhinier mekanik ose teknik, mekanik transport, I (nje) pompist ose motorist, 2 (dy) xhenerike, 1 (nje) elektroaut.

Ne lidhje me kete pike operatori ekonomik ofertues dutet te paraqese: Listepagesat e sigurimeve shoqerore për periudhen (Mars 2019- Maj 2019) ku punonjesit me profesionet perkatese sa me siper të jenë të pasqyruar perkatesisht ne keto lista si dhe kontratat e punes.

Stafi i sipercituar duhet te kene eksperience minimalist 3 muaj pune ne profesionet perkatese te vertetuar me dokumentacion te leshuar nga institucionet e autorizuar me ligj.

Operatori ekonomik "Alstezo" sha Fier kerkon qe te hiqet paragrafi i fundit i cili percakton eksperiencen ne pune te stafit:

Pas shqyrtimit të ankeses AK arriti ne konkluzionin se ky pretendim i OE "Alstezo" sha Fier nuk qendron per arsye se ne kete rast eshte percaktuar eksperienca minimale e kërkuar per punonjesit ne profesionet perkatese dhe ky percaktim eshte bere conform rekomandimit te APP nr 8197, date 03.09.2018 "rekomandim mbi hartimin e kriterëve per kualifikim per procedurat e prokurimit per pune mallra sherbime paragrafi 4 germa c".

Persa me siper pretendimet e operatori ekonomik "Alstezo" sha Fier nuk qendrojne nuk jane te bazuara ne ligji dhe si te tilla nuk merren parasysh pra ankesa nuk pranohet.

II.6. Në datën 05.08.2019 operatori ekonomik "Alstezo" sh.a. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të tenderit dhe shtojcës për modifikimin e dokumentave të tenderit, si më poshtë vijon:

Ankesa jone eshte brenda afateve ligjore te percaktuara ne legjislacionin perkatese sepse ne daten ne daten 17.07.2019 eshte publikuar kjo procedure prokurimi dhe ne daten 22.07.2019 kemi protokolluar ankesa prane Spitalit Fier per kriteret e hartuara ne kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik. Deri ne daten 25.07.2019 nuk morem nje pergjigje nga AK brenda 3 diteve (afati ligjore per shqyrtimin e ankeses). Ne daten 25.07.2019 eshte bere publikimi i shtojces se kesaj procedure prokurimi dhe me date 26.07.2019, brenda afatit 7 ditor nga publikimi i saj paraqitem ankesa tjeter prane AK per te kundërshtuar modifikimin e dokumentave te tenderit pasi nuk u mor parasysh ankesa jone por ne modifikim u publikuan disa kriteret te tjera. Ne daten 29/07/2019 dhe daten 30.07.2019, jashte afatit ligjor per shqyrtim ankesash kane ardhur pergjigjet per ankesat e paraqitura ne Spitalin Fier. Perkatesisht ne daten 22.07.2019 dhe date 26.07.2019. Bashkengjitur keni perkatesisht edhe letren e postes po ashtu edhe gjurmimin e postes. Ju sqarojme prape se kjo procedure prokurimi eshte publikuar ne daten 17.07.2019 dhe ne daten 22.07.2019 paraqitem ankesa prane ketij autoriteti per modifikimin e kriterëve per kualifikim te cilat ishin hartuar ne kundërshtim me ligjin.

Ne daten 25.07.2019 autoriteti kontraktor jo vetem qe nuk ka marre parasysh ankesen tone dhe nuk na ka kthyer pergjigje po ka publikuar ne sistem nje shtojce ku ka modifikuar kriteret dhe shohim qe edhe modifikimi i tyre I cili është bërë jo për pretendimet që kemi ngritur ne si shoqeri,

por per kriteret te tjera ka perseri problem pasi edhe modifikimi i kriterëve është bërë në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik.

Shoqëria jone legjitimohet për të paraqitur ankese, pasi ka interes për këtë procedurë prokurimi dhe jemi brenda afatit të përcaktuar në LPP.

Keto dokumenta si dhe ndryshimet e publikuara përbehen nga kriteret që nuk janë hartuar në përputhje me legjislationin dhe rregullat për prokurimit publik dhe vijnë në kundërshtim me to, pasi janë diskriminuese, përjashtuese dhe jo në përputhje me natyrën dhe objektin e prokurimit. Pasi jemi njohur me Kriteret e Vecanta për Kualifikim, vlerësojmë se nuk janë në përputhje me Ligjin Nr.9643 dt 20/11/2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar Nenin 1, 2, 23 e në vijim, si dhe V.K.M. Nr.914, dt. 29/12/2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Nenin 28, kërkojmë ndryshimin e tyre me arsyetimin, si vijon:

Në si OE kundërshtojmë si kriteret e publikuara në datën 17.07.2019, po ashtu edhe modifikimin e bërë në datën 25.07.2019, për të cilat kemi paraqitur ankese fillimisht edhe në AK. Jemi brenda afatit ligjor për të paraqitur këtë ankese pranë KPP duke i llogaritur afatet si më poshtë. Në datën 22.07.2019 kur paraqitem ankesën e parë në Spitalin fier, për të cilën nuk kishim përgjigje brenda afatit ligjor prej 3 ditësh (jemi njohur nepermjet shërbimit të postës në datën 29.07.2019 që e kemi bashkëngjitur, dhe që nga data 25.07.2019 date edhe kur u publikua shtojca në SPE, fillon afati punës sipas Kpr Administrative që është dita e hënë 05.08.2019.

Edhe në lidhje me ankesën për shtojcën e publikuar në datën 25.07.2019 kemi paraqitur ankesën në Autoritet në datën 26.07.2019 dhe pas mbarimit të afatit 3 ditor, në datë 30.07.2019 fillon afati për në KPP (në 30.07.2019 jemi njohur me përgjigjen nepermjet shërbimit postar që e kemi bashkëngjitur) dhe afati për KPP përfundon në datën 08.08.2019.

Pra, sa më sipër, jemi brenda afatit ligjor për të dyja ankesat si për DST e publikuara në datën 17.07.2019 edhe për Shtojcën e publikuar në datën 25.07.2019. Konkretisht, kundërshtojmë si më poshtë

Kundërshtimi parë:

Në Kërkesat e Vecanta të Kualifikimit, në Kapacitetin Teknik, në dokumentat e publikuara në datën 2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë minimalist, paisje teknike të nevojshme bashkëkohore për realizimin e kontratës, si vijon:

Jo më pak se 2(dy) ura ngritese për automjete me kapacitet jo më pak se 3.5 ton. Pajisje për kontrollin dhe testimin (diagnostikimin) e sistemit elektrik dhe defekteve në motor të automjetit.

Pajisje për cmontimin dhe montimin e gomave në diskun e rrotës së automjetit.

Pajisje për kontrollin balancimin e disqeve gomave automjetit (ballancimi rrotave)

Pajisje për kontrollin dhe realizimin e gjeometrise (konvergences) rrotave të mjetit.

Pajisje për kontrollin dhe mbushje me gaz të sistemit A/C.

Në nenin 23 të ligjit nr 9643 date 20.11.2006 "Për prokurimin publik të ndryshuar parashikohet se [...]. Në nenin 28 të VKM 914, date 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" I ndryshuar, [...].

Pra autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të kërkuar dëshmi për mjetet, por për mjetet që nevojiten për kryerjen e kësaj shërbimi duke i përcaktuar ato në përputhje me zërat e shërbimit që do të kryhen dhe jo duke përcaktuar mjete e pajisje që nuk mbulojnë të gjithë mirëmbajtjes të kërkuara në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

Sa me siper lidhur me Urat ngritese jane kerkuar me kapacitet jo me pak se 3.5 ton, nderkohe qe ambulancat e Spitalit duke kalkuluar peshembajtje edhe me pajisjet spitalore te montuara mbi to, shkojne ne kapacitetin mbi mbi 3.5-4 ton, pra ky kriter duhet te rishikohet duke u bere ne raport me peshen e mjeteve qe do riparohen, pasi kufiri minimal i peshembajtjes eshte me i vogel se vete pasha e mjeteve se bashku me pajisjet.

Spitali Fier ne kthimin e pergjigjes date 24.07.2019 me Nr 3189 Prot. qe ne fakt ne kemi marre dijeni me poste ne daten 29.07.2019 (ashte afatit ligjor, te cilen e keni bashkelidhur kesaj ankese) ka thene se “Ky pretendimi yni nuk qendron per arsye se urat ngritese jane kerkuar me kapacitet mbajtes jo me pak se 3.5 ton dhe jo deri ne 3.5 ton...”

Duam te sqarojme dhe njehere se autoriteti kontraktor ka percaktuar si kufi minimal deri ne 3.5 ton qe domethene qe urat mbajtese duhet te fillojne nga 3.5 ton pra kufiri minimal fillon nga 3.5 ton duke u perfshire edhe ky kapacitet, qe kupton se nje operator me nje kapacitet të tille me urë mbajtëse jo më pak se 3.5 ton, pra që është baraz me 3.5 ton, sipas këtij kriteri do të quhet i kualifikuar, po ne kemi kundërshtuar se ky kriter është hartuar gabim sepse makinerite – mjetet ambulance nisur nga eksperiencia jonë në këte fushë dhe mjetet qe kemi edhe sot ne servis te ketij institucioni sqarojme nga pikepamja teknike se jane mjete te cilat me peshe maksimale te tyre pa pajisjet mjekesore jane total 3.5 ton, ndersa mjeti ambulance se bashku me gjithë pajisjet mjekesore te cilat jane te integruara dhe te pacmontueshme (jane mjete te asambлуara ne menyre te tille ku dhe pjese per funksione te tjera shtese jane integruara ne trupin e mjetit te cilat rrjedhimisht rrisin ne menyre te ndjeshme peshen maksimale te mjetit) tejkalojne ndjeshem këte tonazh dhe shkojne nga 3.8 ton deni ne 4 ton pra flasim per vleren minimale te ures, dhe me këte vlere minimale 3.5 ton ky mjet me peshen me gjithë pajisjet mjekesore qe jane te pandashme nga trupi ambulances dhe si i tille do te ngrihet ne ure, eshte e paperballueshme nga nje ure 3.5 ton. Ne kemi kundërshtuar këte kriter duke thene qe niveli minimal i ures eshte percaktuar deri ne 3.5 ton pra kriteri jo me pak se 3.5 ton do te thote qe kapaciteti i ures duhet te filloje nga 3.5 ton, dhe nuk e kuptojmë pse autoriteti kontraktor ka bërë sikur nuk e ka kuptuar ankesën tonë se ajo e di shume mire kapacitetin e mjeteve që disponon të cilat janë ende edhe ne servisin e shoqerise tone. I gjithë argumenti teknik qëndron ne faktin se nese nje operator ekonomik do te disponoje nje ure me kapacitet 3.5 ton (pra ne perputhje me kriterin se eshte kerkuar jo me pak se 3.5 ton dhe eshte shkruar kupton qe dhe nje ure me 3.5 ton eshte sipas kriterit) a do ta perballoje nje mjet me kapacitet 4 ton sepse kaq shkon pesha maksimale e nje mjeti ambulance me gjithë pajisjet mjekesore te montuara ne to.

Konkretisht po ilustrujme me dokumenta dhe foto lidhur me te dhenat teknike per mjetin me targe AA054KV dhe Shasie Nr EVZZZ2EZF6024521, i cili ndodhet aktualisht ne servisin e Shoqerise Alstezo sha ne Fier, si vijon: (Foto)

Pervec faktit qe ky kriter eshte percaktuar gabim, autoriteti kontraktor ka kerkuar edhe nje dokumentacion i cili nuk e verteton faktin e kapacitetit mbajtes te ures, dhe e ben shume konfuz plotesimin e ketij kriteri (nomalisht per vertetesine e ketij kriteri duhet te kerkohen katalloget e pajisjeve, sidomos urat ngritese ku te jene te perkthyer te dhenat teknike ne gjuhen shqipe) pra nese autoriteti kontraktor vertet kerkon te beje nje verifikim te sakte te kapaciteteve te operatorit ekonomik, atehere katalogu eshte dokumenti i duhur qe ka te percaktuar me sakte se cdo dokument tjetër kapacitetin ne lidhje me mjetet, pasi keto te dhena nuk jane te pasqyruara as ne kontrate e as ne faturat e kerkuara nga spital fier ne dokumentat e tenderit, pra per nje kriter te hartuar

konform ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, autoriteti kontraktor nuk mund të kërkojë dokumenta të cilat përveçse janë hartuar të paqarta e konfuze, si psh kontrata, por edhe nuk arrijnë të japin elemente e duhur se përse kerkohen, pra në përfundim autoriteti kontraktor nuk do të arrijë dot të bëjë verifikimin e pajisjeve që disponon një operator ekonomik nëpërmjet dokumentave të kërkuara.

Me përcaktimin e AK jo më pak se 3.5 ton nuk kemi një hapje të konkurrencës, por kemi një kufizim, një trajtim të barabartë dhe për më shumë që të con drejt kualifikimit të operatoreve që nuk kanë kapacitetet e duhura për të realizuar këto kontrata publike që ka dhe një rendesi dhe interes sepse bëhet fjalë për mjete të shërbimit shëndetësor ndaj mirëmbajtja e tyre është e një rendesie të vecantë.

Sa më sipër, kërkojmë ndryshimin e këtij kriteri duke modifikuar atë dhe duke përcaktuar një kapacitet jo më pak se 4 ton me qëllim përfshirjen e gjithë kategorisë së mjeteve ambulance.

Kundershtimi i dytë:

Me modifikimin e dokumentave të tenderit AK nuk pranoi pretendimin tone duke paraqitur argumentin naiv të mos kuptimit të ankesës dhe modifikoi duke shtuar në fund të këtij kriteri edhe një paragraf tjetër duke e bërë kriterin si më poshtë:

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht, pajisje teknike të nevojshme bashkëkohore për realizimin e kontratës, apo pajisje teknike që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën si vijon:

- Jo më pak se 2 (dy) ura ngritese për automjete me kapacitet jo më pak se 3.5 ton
- Pajisje për kontrollin dhe testimin (diagnostikimin) e sistemit elektrik dhe defekteve në motorin e automjetit.
- Pajisje për zmontimin dhe montimin e gomave në diskun e rrotës së automjetit.
- Pajisje për kontrollin & balancimin e disqeve & gomave të automjetit (ballancimi i rrotave).
- Pajisje për kontrollin dhe realizimin e gjeometrisë (konvergjencës) të rrotave të mjetit.
- Pajisje për kontrollin dhe mbushje me gaz të sistemit A/C

Në lidhje me këto pike operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

☐ Dokumenta që vërtetojnë se këto mjete apo pajisje i ka në pronësi (të paraqitet fatura blerje brenda vendit, ndërsa në rastet e blerjes jashtë vendit, faturat e blerjes të jenë të shoqëruar me dokument çdoganimi të tyre në emër të shoqërisë) ose për pajisjet dhe mjetet e marra me qira të paraqitet kontrata e qirase e cila duhet të jetë e vlefshme për periudhën e realizimit të kontratës

☐ Në rastin e pajisjeve që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën duhet të paraqesë kontratën përkatëse conform dispozitave të Kodit Civil ku të përcaktohet disponueshmëria e pajisjeve dhe mjeteve të kërkuara për kryerjen e këtij shërbimi nga operatori ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë. Kontrata duhet të jetë e vlefshme për periudhën e realizimit të kontratës.

Në datën 26.07.2019 paraqitem ankese në AK sepse për paragrafin

-Në rastin e pajisjeve që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën duhet të paraqesë kontratën përkatëse conform dispozitave të Kodit Civil ku të përcaktohet disponueshmëria e pajisjeve dhe mjeteve të kërkuara për kryerjen e këtij shërbimi nga operatori ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë. Kontrata duhet të jetë e vlefshme për periudhën e realizimit të kontratës.

Kemi ankimuar ne autoritet se nuk kuptojme se cfare ka dashur te thote autoriteti kontraktor dhe cfare ka kerkuar ne te vertete. Kriteri i hartuar keshu, ashtu sic percakton edhe KPP ne vendimet e tij, eshte i paqarte konfuz, si per operatore ekonomik ashtu edhe per vete autoritetin kontraktor dhe KVO dhe nuk kuptohet qellimi i vendosjes se ketij kriteri dhe cfare kerkon te vertetoje autoriteti kontraktor me nje kriter te tille, pasi nuk i sherben kesaj procedure prokurimi dhe nuk është në përputhje me natyren dhe permasat e kesaj procedure prokurimi.

Ky kriter eshte i paqarte pasi eshte kerkuar kontrate ku te percaktohet disponueshmeria e paisjeve, nje kriter i pakuptimte dhe jo ne përputhje e propocion me objektin e natyren e kesaj procedure prokurimi. Autoriteti kontraktor kur ka kthyer pergjigje ka qene akoma me kontradiktor kur citon ne kriter disponimin nderkohe qe ne kthim pergjigje thote qe megjithese mund te mos i kete ne disponim keto pajisje (ne pronesi ose me qera) ne momentin e hapjes se procedures, ai ne rast se shpallet fitues, I ka te siguruara nepermjet nje kontrate me kusht apo kontrate porosie!!!

Kundershtojme kete argumentim te autoriteit kontraktor, pasi se pari AK legjitimon qe ne fillim faktin qe ne momentin e hapjes se ofertave nje operator ekonomik mund te mos i kete ne disponim e pronesi apo qira mjetet, pra tregon qe nje operator do te kualifikohet, nese nuk i disponon mjetet dhe nese shpallet fitues-dmth do te kualifikohet pa plotesuar kriteret, por qeai pas shpalljes fitues ai mund t'i kete te siguruara mjetet me kontrate me kusht ose porosie.

Se kuptojme kete arsyetim te AK te pabazuar ligjerisht dhe duke pranuar qe do kualifikoje operatore qe nuk i disponojne kapacitet e duhura e te nevojshme per kete procedure prokurimi. Kontrata me kusht ose porosie nuk jane kontrata qe aplikohen per kete lloj sherbimi sepse kemi te bejme me nje procedure qe kerkon riparim dhe mirembajtje mjetesh te nje rendesie te vecante dhe prioritare te emergjences, qe jane spitalore, ne kete menyre kerkon nje autoservis per keto automjete ku pajisjet kerkohen te jene te instaluar ne te, pra kerkohet qe pajisjet te jene te instaluar dhe ne funksionim te plote pune ndaj kontrata me kush apo porosie nuk ka kuptim dhe nuk duhet ne kete procedure prokurimi specifike, pasi dhe sherbimi eshte i tille pra servis kerkohet dhe duhet te jete ne pune, funksional dhe i pasqyruar ne QKB ne aktivitetin qe ushtron OE, qe do te thote jo vetem ambjenti po dhe pajisjet qe sherbejne per kete qellim duhet te jene te montuara e ne angazhim e funksionim te plote me qellim realizimin me sukses te kontrates. Ne rast se kontrata do jete me kusht ose porosie atehere ckuptim ka kjo procedure prokurimi qe ne qender te saj ka riparimin dhe mirembajtjen e mjeteve te cilat behen vetem ne nje servis i cili ka mjetet e instaluar e ne pune te gatshme per kryerjen e sherbimit nderkohe, nderkohe qe kontrata e porosise ose me kusht nuk siguron realizimin e kontrates me sukses? Gjithashtu me kete pergjigje qe kthen AK e cila nuk eshte shprehur dhe publikuar ne DST, ligjeron qe do kualifikoje operator ekonomike qe nuk i disponojne keto mjete ne hapjen e tenderit se keshtu e ka shprehur vete ne kthimin e pergjigjes. Ky sherbim ka qellimin kryesor riparimin dhe mirembajtjen e mjeteve, sherbim qe nuk behet pa pasur servisin dhe pajisjet e duhura, pra pa vertetuar se nje operator ekonomik disponon keto kapacitete qe ne momentin e hapjes se ofertave.

Disponimi ne kuptim te legjislacionit te prokurimit publik si edhe te kodit civil ka te beje me faktin e disponimit-pronesi ose qera keshu qe nuk e kuptojme absolutisht paragrafin "Ne rastin e pajisjeve qe mund t'i vihen ne dispozicion ..." Si dhe sqarimin qe jep AK per kete percaktim ne kthimin e pergjigjes, qe e ben edhe me konfuz plotesimin e ketij kriteri.

AK me kete menyre te percaktimit te kriterit, jo vetem qe nuk hap konkurrencen, por e kufizon ate dhe e con drejt nje operatori te vetem madje edhe te paracaktuar per te fituar kete procedure. Ne

rast se autoriteti kontraktor kerkon te verifikojë disponimin e ketyre kapaciteteve (pajisjeve) për kryerjen e shërbimit, ashtu siç argumentum me lart, ky verifikim behet nepermjet katalogeve që kanë të dhëna teknik të pajisjeve dhe janë dokumentacion i lidhur ngushtesisht dhe që shoqëron cdo mjet apo pajisje, dhe jo nepermjet dokumentave të kerkuara e të shtuara me shtojcën e AK, pasi nga ato nuk verifikon asnjë parameter dhe nuk kupton se cilat kapacitete disponon një operator ekonomik për të përket pajisjeve që duhet për këto shërbime.

Përgjigja e AK që "...nënkupton që një operator ekonomik megjithatë mund të mos i ketë në disponim këto pajisje (në pronesi ose me qera) në momentin e hapjes së procedurës, ai në rast se shpallet fitues i ka të siguruara nepermjet një kontrate me kusht apo kontrate porositëse..." nën të mendojmë që kjo kontratë qenka hipotetike, e paracaktuar dhe dihet kush do ta fitojë këtë procedurë. Ndaj kërkojmë heqjen e këtij kriteri si të paqartë, konfuz të tepër, diskriminues dhe pa kuptim në lidhje me këtë procedurë prokurimi dhe saktësinë e kriterit për përcaktimin e kapaciteteve të pajisjeve që duhet të disponojnë OE ofertues.

Kundershtimi i tretë:

Në dokumentat e tenderit të publikuara duke parë zërat e shërbimeve që do të kryhen për riparimet e mjeteve, objekt i këtij prokurimi, rezulton se autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatorët ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi për të vertetuar se disponojnë kapacitetet e duhura në lidhje me mjetet që paracaktuar vetëm pajisje të tilla për riparimin dhe mirëmbajtjen e gomave, apo disqeve të gomave, pajisje këto të cilat nuk shërbejnë për mbulimin e të gjitha shërbimeve të kerkuara nga autoriteti kontraktor për këto objekt prokurimi, të përcaktuara këto në Shtojcën 8 të DST dhe jo vetëm, por në asnjë prej zërave të riparimit nuk kemi procese të punës që lidhen teknikisht me këto pajisje. Nisur nga zërat e shërbimit për riparimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve rezulton se ka shumë shërbime të cilat nuk mbulojnë nga pajisjet që ka kërkuar autoriteti kontraktor, pra autoriteti kontraktor bazuar në parimet dhe qëllimet e ligjit për prokurimin publik për mosdiskriminimin në transparencë dhe trajtimin e barabartë si edhe mirëperdorimin e fondeve publike, duhet të përcaktojë kritere me qëllim verifikimin nëse një operator ekonomik disponon të gjitha kapacitetet e duhura për kryerjen me sukses të këtij shërbimi aq më tepër kur kemi të bëjmë me shërbim të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve Ambulanca të Spitalit Fier, mjet këto të cilat kanë të bëjnë edhe me një interes publik të madh siç është jeta e qytetarëve. Për këto arsye autoriteti kontraktor nuk mund të përcaktojë kritere të cilat mbulojnë apo përfaqësojnë pajisje të nevojshme që ndikojnë në realizimin vetëm të disa shërbimeve, por që dhe këto në fakt nuk janë të përfaqësuara në zërat e riparimit të mjeteve të përcaktuara në DST duke lënë jashtë një pjesë të mirë të funksioneve të tyre si edhe duke mos përmbushur aftësinë teknik të domosdoshme që detyrimisht duhet ta ketë cdo operator ekonomik i interesuar për të qenë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor nuk mundet të kërkojë pajisje vetëm për gomat apo disqet e gomave pasi vetëm këto pajisje nuk mund të kryejnë shërbimet e riparimeve që janë paracaktuar nga vete Autoriteti kontraktor në DST të tilla siç janë linja e kontrollit dhe diagnostikimit të defekteve jo vetëm në motor (të rendesishme si procese pune të shërbimeve të kerkuara nga AK në DST) linjë kjo e cila ka pajisje shumë të rendesishme dhe pa të cilat nuk mund të kryhet riparimi dhe mirëmbajtja, kontrolli dhe diagnostikimi i gjendjes teknik xherike të mjeteve të kerkuara në DST para dhe pas riparimit. Konkretisht shërbimet në lidhje me kontrollin e sistemit të frenimit të mjetit, kontrolli në lidhje me sistemin e amortizimit të mjetit, kontrolli i sistemit të drejtimit të mjetit (xhokove etj) si edhe

sherbime te tjera te permendura dhe listuara nga autoriteti kontraktor ne dokumentat e tenderit nuk mund te behen me pajisjet per gomate apo ballancimit te disqeve te gomave. Autoriteti kontraktor duhet te percaktojë kriteret ne perputhje dhe perpjesetim me natyren dhe permasat e kontrates objekt prokurimi dhe ne perputhje me zerat e sherbimit te kerkuar rrjedhimisht duhet te percaktojë edhe kriteret per pajisjet qe nje operator ekonomik disponon ose mund te disponoje ne lidhje me kryerjen e ketij sherbimi me qellim verifikimin nese ky operator disponon te gjitha mjetet e duhura dhe te rendesishme per kryerjen e nje sere sherbimesh te domosdoshme ne lidhje me mjetet qe autoriteti kontraktor ka percaktuar ne dokumentat e tenderit.

Ne dokumentat e tenderit objekti i ketij prokurimi nuk eshte vetem sherbimi i riparimit dhe mirembajtjes se gomave apo disqeve te gomave, por jane percaktuar edhe shume sherbime te tjera shume me te rendesishme qe lidhen me mirembajtjen dhe riparimin e automjeteve. Procesi i kontrollit dhe riparimit eshte nje proces kyc dhe shume i rendesishem ne riparimin dhe mirembajtjen e mjeteve, qe ne kete rast eshte dhe objekti i prokurimit te publikuar nga autoriteti kontraktor Spitali Fier, dhe ky proces i pare edhe nga zerat e sherbimit qe ka publikuar Spitali Fier kerkon qe nje OE te jete i afte teknikisht per te kryer keto sherbime dhe per te perballuar keto sherbime riparime dhe kontrolli per realizimin teknikisht te ketyre sherbime qe do te thote perballimin per realizimin si nga ana profesionale pra te kete punonjesit dhe profesionistet e duhur, por ashtu edhe nga ana e disponimit te pajisjeve te duhura te domosdoshme e te nevojshme per kryerjen e ketij sherbimi, pra ajo e pajisjeve qe nje OE ka ne dispozicion per te mbuluar te gjitha zerat e sherbimit te kerkuar nga autoriteti kontraktor ne dokumentat e tenderit.

Edhe Komisioni i Prokurimit Publik ne raste te tilla te ngjashme ka mbajtur te njejtin qendrim, ndaj autoriteti kontraktor duhet te beje modifikimet e duhura ne perputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit si edhe me natyren e ketij sherbimi dhe kesaj procedure prokurimi. Sic thame dhe me lart dukshem ne linjen e kontrollit dhe diagnostikimit te difekteve, eshte hequr me qellim pajisjet shume te rendesishme pa te cilat nuk mund te kryhet kontrolli i gjendjes teknike te mjetit para dhe pas riparimit, sikurse jane

Pajisje per sistemin e kontrollit te frenimit te mjetit

Pajisje per sistemin e kontrollit te amortizimit te mjetit

Pajisje per kontrollin e sistemit te drejtimit te mjetit (xhokove etj)

Autoriteti kontraktor ne kthimin e pergjigjes thote qe:

Operatori ekonomik kerkon shtim kriteresh gje e cila muk i sherben realizimit te kontrates pasi defektet jane tashme të konstatuara dhe nuk përfshihen në shërbimet e kërkuara, pra nuk është kerkuar kontroll te sistemit te frenimit, kontroll i amortizimit te mjetit apo kontroll i sistemit të drejtimit te mjetit (xhokove etj).

Ne lidhje me kete pergjigje duam te sqarojme dhe njehere teknikisht se mjeti kontrollohet qe ne hyrje per te identifikuar problemin apo defektin qe ka, dhe per te pare gjendjen teknik te detajuar si dhe difektet ne momentin aktual si sistem frenimit, drejtimit, amortizimit.etj.

Eshte e qarte dhe e ditur qe kontrolli i nje mjeti presupozon percaktimin e gjendjes se tij teknike ne momentin aktual duke pasur parasysh ketu kontrollin e sistemit te frenimit (qe eshte sistemi kryesor i nje mjeti), sistemin e drejtimit- edhe ky nje sistem i rendesishem ne mjet, si dhe drejtimi amortizimit qe jane kerkuar ne DST.etj.etj.

Keto sisteme edhe pse AK citon ne pergjigje qe si ka kerkuar ne zërat e riparimit, ne po i ilustrujme duke i renditur me poshte marre nga DST te percaktuara nga vete AK

AK nuk eshte i sakte kur thote qe defektet jane tashme te konstatuara pasi kjo eshte nje procedure marreveshje kuader ku behet fjale per sasi te pritshme qe dmth se AK nuk di se sa dhe cilat riparime do te behen, duke u hedhur poshte argument qe thote se i ka te konstatuara defektet. Nderkohe ne Shtojcen 8 te DST, Specifikimet Teknike, midis te tjerash, thuhet

- Automjetet do te dorezohen dhe merren (pas kryerjes se sherbimit) nga servisi i operatorit ekonomik me proces-verbal te rregullt nga punonjesit e autorizuar te Spitalit Rajonal Fier

- Ne proces verbal duhet te pasqyrohen sakte :

- ✓ tipi i automjetit

- ✓ data e hyrjes se automjetit ne servis

- ✓ sherbimet e kryera

- ✓ data e daljes nga servisi

- ✓ proces verbali duhet te nenshkruhet nga perfaqesuesit e operatorit ekonomik si dhe nga personeli i autorizuar i Spitalit Rajonal Fier

- Ne perfundim te procesit te riparimit, do te kryhet perseri kontrolli ne pajisjet diagnostifikuese dhe do te nxirret raporti i te dhenave teknike pas riparimit. Puna e kryer do te quhet e mirëqene kur ajo te miratohet ne zëra dhe ne cilësi nga përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor dhe situacioni do te firmoset nga drejtuesi i mjetit, perfaqesuesi i Autoritetit Kontraktor, punonjesi i riparimit dhe drejtuesi teknik i operatorit ekonomik. Operatori Ekonomik do te leshoje faturen tatimore duke e shoqeruar me garancine e punimeve.

Pra, vete AK thote qe".. Ne perfundim te procesit te riparimit, do te kryhet perseri kontrolli ne pajisjet diagnostifikuese dhe do te nxirret raport i te dhenave teknik pas riparimit." Kjo kerkese e vendosur nga AK, presupozon qe detyrimisht OE duhet te kete pajisje per kontrollin perseri te gjendjes teknik lidhur me riparimin e kryer, mbi bazen e te cilave "...do te nxirret raporti i te dhenave teknike pas riparimit..."

Teknikisht sqarojme se difektet jane te percaktuara vetem sa i perket sherbimeve normative te percaktuara ne baze te kilometrave te pershkruara, si psh nderrimi i filtrave vajit ajri, naftë etj, por qe ne rastin konkret nuk egzistojne ne listen e parashikimeve te riparimeve te pritshme ne Shtojcen 1 te DST, pasi me sa kemi informacion dhe njohuri si shoqeri me shume eksperience ne fushen e sherbimit te riparimit dhe mirembjebes se automjeteve, behen ne procedure tjeter prokurimi.

Duke qene se eshte marrveshje kuader, percaktimi i riparimeve ne automjetet qe do te kryhen rast pas rasti, do te behet duke kontrolluar paraprakisht mjetin ne servis ne prezencen e paleve. Duke ju referuar akoma pergjigjes se ankmimit nga ana e AK, konstatojme giithashtu se AK ka kerkuar pajisje qe nevojiten per efekt riparimi lidhur me zera qe as nuk i ka parashikuar fare ne DST dhe konkretisht

- Pajisje per zmontimin dhe montimin e gomave ne diskin e rrotes se automjetit

- Pajisje per kontrollin & balancimin e disqeve dhe gomave automjetit (ballancimi rrotave)

Ne si OE ne ankimin tone nuk kemi kerkuar shtim kriteri, por hartim te tij ne perputhje me nevojat per pajisje teknik që sherbejne per realizimin e zerave te sherbimeve te kerkuara dhe percaktuara ne dokumentat e tenderit pasi eshte e vertete qe pajisjet e kerkuara mund te jene pjese perberese e një servisi qe ne rastin konkret nuk kane asnje lidhje me objektin e prokurimit dhe nuk jane domosdoshmeri per t'u kerkuar, sepse nuk mbulojne asnje nga sherbimet e zerave qe jane kerkuar ne DST dhe qe do te kryhen si pjese e ketij sherbimi, pra pajisjet e kerkuara

- Paisje per zmontimin dhe montimin e gomave ne diskin e rrotes se automjetit

- Paisje per kontrollin&balancimin e disqeve&gomave automjetit (ballancimi rrotave)

jo vetem qe jane vene dhe kerkuar si pajisje qe nuk kane lidhje me sherbimet e kryera pra me sherbimet e kerkuara ne DST nga autoriteti kontraktor, por nuk kryejne dhe mbulojne vertet sherbimet konkrete qe jane kerkuar dhe qe do te kryhen ne lidhje me zerat e kerkuar ne dokumentat e tenderit per kete sherbim sikurse jane zerat e riparimit per sistem frenimi, amortizimi, drejtimi etj, pasi keto jane funksione dhe sherbime qe kryhen vetem nga pajisje te tilla si

Pajisje per sistemin e kontrollit te frenimit te mjetit

Pajisje per sistemin e kontrollit te amortizimit te mjetit

Pajisje per kontrollin e sistemit te drejtimit te mjetit (xhokove etj)

Ne asnje rast ne nuk kemi kerkuar shtim kriteri, por kemi kerkuar perputhje dhe percaktim te sakte te pajisjeve te kerkuara, te cilat sherbejne ne perputhje me sherbimet qe do te kryhen dhe zerat e sherbimeve te percaktuar ne DST nga AK. Jo vetem kaq, por nga ana e AK duhet te kerkohen edhe katalloget perkates te shoqeruar me te dhenat teknike te ketyre pajisjeve per te ilustruar dhe argumentuar ne menyre korrekte funksionin dhe parametrat e tyre, ne perputhje me kerkesat dhe specifikimet teknike te kerkuara nga AK, pasi vetem ky eshte dokumenti i duhur per verifikimin e kapaciteteve te pajisjeve te kerkuara, nese ak do te donte te bente nje verifikim te sakte mbi disponimin e ketyre pajisjeve.

Sa me siper, lidhur me kete pike, kerkojme perfundimisht qe AK te beje ndryshimet e mesiperme ne KVK e DT, duke saktësuar pajisjet e mesiperme te domosdoshme per kryerjen e ketij sherbimi dhe realizimin me sukses te kesaj kontrate sikurse jane: pajisiet per kontrollin e sistemit te drejtimit te mjetit (xhokove) ne perputhje keto edhe me kerkesat per riparim te mjeteve te paraqitura ne zerat e kerkuara ne DST nga AK.

Kundershtimi i katert:

Në datën 26.07.2019 pas modifikimit kemi ankimuar prane AK edhe kriterin

Ne dokumentat e tenderit pas modifikimit ne piken 2.3. 1 eshte vendosur kriteri:

2.3. 1 Operatori ekonomik ofertues duhe te kete ne statin e tij te punesuar te perhershëm ose me kontrate jo me pak se 5 (pese) punonjes mesatarisht per cdo muaj per periudhen Mars 2019 - Maj 2019, nga te cilet ne stafin teknik te jene te punesuar pergjegjesi teknik/drejtesu teknik, i cili duhet te jete inxhinier mekanik ose teknik, mekanik transport, 1 (nje) pompist ose motorist, 2 (dy) xhenerike, 1 (nje) elektroaut.

Ne lidhje me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese:

Listepagesat e sigurimeve shoqerore per periudhen (Mars 2019-Maj 2019) ku punonjesit me profesione perkatese sa me siper te jene te pasqyruar perkatesisht ne keto lista si dhe kontratat e punes.

Stafi i sipercituar duhet te kene eksperience minimalist 3 muaj pune ne profesione perkatese te sipercituara vertetuar me dokumentacion te leshuar nga institucionet e autorizuar me ligj.

Edhe per kete kriter autoriteti kontraktor prape ka diskriminuar duke vendosur pa kuptim dhe pa lidhje me kete procedure prokurimi. Autoriteti kontraktor kerkon qe keta punonjes te jene ne listepagese per periudhen Mars 2019 - Maj 2019 si dhe kontratat e punes, per te vertetuar qe OE ka kapacitetet e duhura ne lidhje me stafin.

Me modifikimin e publikuar ne datën 25.07.2019 autoriteti kontraktor ka shtuar edhe kriterin:

Stafi i sipercituar duhe te kene eksperience minimalisht 3 muaj pune ne profesionet perkatese te sipercituara vertetuar me dokumentacion te leshuar nga institucionet e autorizuar me ligj.

Ky shtim kriteri eshte i paqarte i pakuptimte dhe nuk kuptojme qellimin e AK pse e ka vendosur. AK kerkon qe stafi te kete eksperience minimalist 3 muaj pune ne profesionet perkatese dhe kerkon te vertetohet kjo me dokumentacion te leshuar nga institucionet e autorizuar me ligj. Ky percaktim eshte kontradiktor dhe i paqarte sepse AK nuk ka percaktuar se kush jane institucionet e autorizuar me ligj qe leshojne nje dokument te tille per profesionet me lart apo per eksperiencen 3 mujore qe ka kerkuar AK, per me teper qe duket nje kriter i teper e pa sens logjik.

Ak per te vertetuar kapacitetet ne lidhje me stafin duhet te mjaftohet me listepagesat ku punonjesit me profesionet perkatese te jene te perfshire si edhe me kontratat e punes, si dhe deshmite profesionale te punonjesve. Kerkesa e shtuar ne modifikim eshte e teper, diskriminuese, jo ne perpjesetim me objektin dhe natyren e prokurimit dhe si sherben aspak qellimit te AK per vertetimin e disponimit te kapaciteteve nga ana e OE.

AK ne kthimin e pergjigjes thote qe ky kriter eshte percaktuar per eksperienca minimale te punonjesit ne profesionet perkatese dhe eshte bere sipas rekomandimit te APP dt.03.09.2018 nr 8197, per hartimin e kriterëve. Sqarojme dhe nje here qe ne nuk kemi ankimuar per periudhen e eksperiences por autoriteti kontraktor nuk ka dashur te kuptoje. Shoqeria jone ka kundërshtuar menyren e hartimit te ketij kriteri qe eshte e paqarte dhe konfuze dhe si sherben kesaj procedure prokurimi.

AK ka percaktuar kete kriter por nuk ka percaktuar se kush jane institucionet e autorizuar me ligj qe leshojne nje dokument te tille per profesionet me lart apo per eksperiencën 3 mujore qe ka kerkuar AK, per me teper qe duket nj kriter i teper e pa sens logjik.

Paragrafi Stafi i sipercituar duhet te kene eksperience minimalist 3 muaj pune ne profesionet perkatese te sipercituara vertetuar me dokumentacion te leshuar nga institucionet e autorizuar me ligji, nuk ka sens dhe eshte hartuar gabim pasi AK per te vertetuar kapacitetet ne lidhje me stafin duhet te mjaftohet me listepagesat per periudhen e kerkuar ku punonjesit me profesionet perkatese te jene te perfshire si edhe me kontratat e punes, si dhe deshmite profesionale te punonjesve.

Ashtu sic eshte formular nuk kuptohet se cfare duhet dokumentacioni duhet te sillet nga institucionet e autorizuar me ligj, per te vertetuar eksperiencen 3 muaj pune apo per te vertetuar profesionet perkates te sipercituara. Per kete arse kemi kerkuar heqjen e ketij kriteri si teper e te paqarte.

Si përfundim kerkojme heqjen e ketij percaktimi si diskriminues e përjashtues, te tepert e te pakuptimte, duke kufizuar konkurrencën dhe pjesëmarrjen ne procedure e prokurimit, ose modifikimin dhe riformulimin e tij në përputhje me LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

II.7. Në datën 21.08.2019, nëpërmjet shkresës nr. 3537 Prot., datë 19.08.2019, me objekt “Dërgim informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesat e operatorit ekonomik “Alstezo” sh.a.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Alstezo” sh.a. për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se *“Sa me siper lidhur me Urat ngritese jane kerkuar me kapacitet jo me pak se 3.5 ton, nderkohe qe ambulancat e Spitalit duke kalkuluar peshembajtje edhe me pajisjet spitalore te montuara mbi to, shkojne ne kapacitetin mbi mbi 3.5-4 ton, pra ky kriter duhet te rishikohet duke u bere ne raport me peshen e mjeteve qe do riparohen, pasi kufiri minimal i peshembajtjes eshte me i vogel se vete pasha e mjeteve se bashku me pajisjet”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, shtojca 7, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.4. “Për kapacitetin teknik”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin:

“2.3.4 Operatori ekonomik duhet te kete minimalisht, paisje teknike te nevojshme bashkekohore per realizimin e kontrates, si vijon:

- *Jo me pak se 2 (dy) ura ngritese per automjete me kapacitet jo me pak se 3.5 ton*
- *Pajisje për kontrollin dhe testimin (diagnostikimin) e sistemit elektrik dhe difekteve në motorr të automjetit.*
- *Paisje per zmontimin dhe montimin e gomave ne diskun e rrotës së automjetit.*
- *Paisje per kontrollin&balancimin e disqeve&gomave automjetit (ballancimi rrotave).*
- *Paisje per kontrollin dhe realizimin e gjeometrise (konvergences) rrotave te mjetit.*
- *Pajisje per kontrollin dhe mbushje me gaz te sistemit A/C*

Ne lidhje me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese:

Dokumenta qe vertetojne se keto mjete apo pajisje i ka ne pronesi (te paraqitet fature blerje brenda vendit, ndersa ne rastet e blerjes jashte vendit, faturat e blerjes te jene te shoqeruar me dokument çdoganimit te tyre ne emer te shoqerise) ose per pajisjet dhe mjetet e marra me qira te paraqitet kontrata e qirase e cila duhet te jete e vlefshme per periudhen e realizimit te kontrates.”

III.1.2. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, I ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”*

III.1.3. Në nenin 1 pika 2 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

2. Qëllimi i këtij ligji është:

a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;

b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1 pika 2 të LPP.

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi. Në rastin konkret, nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, në lidhje me kapacitetin e pajisjes urë gritëse për automjete, KPP gjykon se, autoriteti kontraktor në kriterin e mësipërm ka përcaktuar një kapacitet minimal të urës ngritëse jo më të vogël se 3.5 ton, duke lënë kështu të hapur mundësinë e një pjesëmarrje sa më të gjerë të operatorëve ekonomikë. Sa më sipër, KPP gjykon se njësia e prokurimit pranë autoritetit kontraktor ka parashikuar kriteret minimale kualifikuese, të gjykuar të nevojshëm për vërtetimin e plotësimit të kapacitetit teknik të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, konkretisht të kapacitetit të urave mbajtëse për automjetet. Sa më sipër, KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar se është në të drejtën e autoritetit kontraktor të parashikojë kriteret minimale kualifikuese në një procedurë prokurimi në përputhje me llojin e shërbimit, specifikën dhe karakteristikat e tij, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes dhe konkurrencës së operatorëve ekonomikë, stimulimin e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Alstezo” sh.a., se *“Përvec faktit që ky kriter është percaktuar gabim, autoriteti kontraktor ka kerkuar edhe një dokumentacion i cili nuk e verteton faktin e kapacitetit mbajtes të ures, dhe e ben shume konfuz plotesimin e ketij kriteri (nomalisht për vertetesine e ketij kriteri duhet të kerkohen katalloget e pajisjeve, sidomos urat ngritese ku të jene të perkthyer të dhenat teknike në gjuhen shqipe) pra nese autoriteti kontraktor vertet kerkon të bejë një verifikim të sakte të kapaciteteve të operatorit ekonomik, atehere katalogu është dokumenti i duhur që ka të percaktuar me sakte se cdo dokument tjetër kapacitetin në lidhje me mjetet, pasi keto të dhena nuk janë të pasqyruara as në kontratë e as në faturat e kerkuara nga spitali për në dokumentat e tenderit, pra për një kriter të hartuar konform ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, autoriteti kontraktor nuk mund të kerkojë dokumenta të cilat përvecse janë hartuar të paqarta e konfuzë, si për kontratën, por edhe nuk arrijnë të japin elemente të duhur se përse kerkohen, pra në përfundim autoriteti kontraktor nuk do të arrijë dot të bejë verifikimin e pajisjeve që disponon një operator ekonomik nepermjet dokumentave të kerkuara”*, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ky pretendim është ngritur vetëm në ankesën e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe jo në ankesën e depozituar pranë autoritetit kontraktor, në respekt të shkallëve të ankimimit percaktuar në ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, neni 63, pika 1.1 dhe 7 ku parashikohet se: *“1.1 Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. [...] Mosndjekja e shkallëve të ankimit e bën ankesën të pavlefshme.”*

Sa më sipër ky pretendim i ankimuesit nuk meret në shqyrtim.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se: *“Në datën 26.07.2019 paraqitem ankese në AK sepse për paragrafin -Në rastin e pajisjeve që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën duhet të paraqesë kontratën perkatese konform dispozitave të Kodit Civil ku të percaktohet disponueshmeria e pajisjeve dhe mjeteve të kerkuara për kryerjen e ketij shërbimi nga operatori ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë. Kontrata duhet të jetë e vlefshme për periudhën e realizimit të kontratës. Kemi ankimuar në autoritet se nuk kuptojmë se çfarë ka dashur të thotë autoriteti kontraktor dhe çfarë ka kerkuar në të vertetë. Kriteri i hartuar kështu, ashtu siç percakton edhe KPP në vendimet e tij, është i paqartë konfuz, si për operatore ekonomik ashtu edhe për vetë autoritetin kontraktor dhe KVO dhe nuk kuptohet qëllimi i vendosjes së ketij kriteri dhe çfarë kerkon të vertetojë autoriteti kontraktor me një kriter të tillë, pasi nuk i shërben kësaj procedure prokurimi dhe nuk është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kësaj procedure prokurimi.*

Ky kriter është i paqartë pasi është kerkuar kontratë ku të percaktohet disponueshmeria e pajisjeve, një kriter i pakuptimtë dhe jo në përputhje e propocion me objektin e natyrën e kësaj procedure prokurimi. Autoriteti kontraktor kur ka kthyer pergjigje ka qenë akoma me kontradiktore kur citon në kriter disponimin nderkohe që në kthim pergjigje thotë që megjithatë mund të mos i ketë në dispozicion keto pajisje (në pronesi ose me qera) në momentin e hapjes së procedurës, ai në rast se shpallet fitues, I ka të siguruar nepermjet një kontrate me kusht apo kontrate porositë!!!

Kundershtojme kete argumentim te autoriteit kontrator, pasi se pari AK legjitimon qe ne fillim faktin qe ne momentin e hapjes se ofertave nje operator ekonomik mund te mos i kete ne disponim e pronesi apo qira mjetet, pra tregon qe nje operator do te kualifikohet, nese nuk i disponon mjetet dhe nese shpallet fitues-dmth do te kualifikohet pa plotesuar kriteret, por qeai pas shpalljes fitues ai mund t'i kete te siguruara mjetet me kontrate me kusht ose porosie. ” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në Shtojcën nr 2, të publikuar nga autoriteti kontraktor për modifikimin e dokumentave të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, pika 2.3.4 e ”Kapacitetit teknik” është modifikuar si më poshtë:

ESHTE

2.3.4 Operatori ekonomik duhet te kete minimalisht, paisje teknike te nevojshme bashkekohore per realizimin e kontrates, si vijon:

- Jo me pak se 2 (dy) ura ngritese per automjete me kapacitet jo me pak se 3.5 ton*
- Pajisje për kontrollin dhe testimin (diagnostikimin) e sistemit elektrik dhe difekteve në motorr të automjetit.*
- Paisje per zmontimin dhe montimin e gomave ne diskun e rrotës se automjetit.*
- Paisje per kontrollin&balancimin e disqeve&gomave automjetit (ballancimi rrotave).*
- Paisje per kontrollin dhe realizimin e gjeometrise (konvergjences) rrotave te mjetit.*
- Pajisje per kontrollin dhe mbushje me gaz te sistemit A/C*

Ne lidhje me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese:

Dokumenta qe vertetojne se keto mjete apo pajisje i ka ne pronesi (te paraqitet fature blerje brenda vendit, ndersa ne rastet e blerjes jashte vendit, faturat e blerjes te jene te shoqeruar me dokument çdoganimi te tyre ne emer te shoqerise) ose per pajisjet dhe mjetet e marra me qira te paraqitet kontrata e qirase e cila duhet te jete e vlefshme per periudhen e realizimit te kontrates

BEHET

2.3.4 Operatori ekonomik duhet te kete minimalisht, paisje teknike te nevojshme bashkekohore per realizimin e kontrates, apo pajisje teknike që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën si vijon:

- Jo me pak se 2 (dy) ura ngritese per automjete me kapacitet jo me pak se 3.5 ton*
- Pajisje për kontrollin dhe testimin (diagnostikimin) e sistemit elektrik dhe difekteve në motorr të automjetit.*
- Paisje per zmontimin dhe montimin e gomave ne diskun e rrotës se automjetit.*
- Paisje per kontrollin&balancimin e disqeve&gomave automjetit (ballancimi rrotave).*
- Paisje per kontrollin dhe realizimin e gjeometrise (konvergjences) rrotave te mjetit.*
- Pajisje per kontrollin dhe mbushje me gaz te sistemit A/C*

Ne lidhje me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese:

☐ *Dokumenta qe vertetojne se keto mjete apo pajisje i ka ne pronesi (te paraqitet fature blerje brenda vendit, ndersa ne rastet e blerjes jashte vendit, faturat e blerjes te jene te shoqeruar me dokument çdoganimi te tyre ne emer te shoqerise) ose per pajisjet dhe mjetet e marra me qira te paraqitet kontrata e qirase e cila duhet te jete e vlefshme per periudhen e realizimit te kontrates*

□ *Ne rastin e pajisjeve që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën duhet te paraqese kontraten perkatese conform dispozitave te Kodit Civil ku te percaktohet disponueshmeria e pajisjeve dhe mjeteve te kerkuara per kryerjen e ketij sherbimi nga operatori ekonomik pjesmarres ne kete procedure. Kontrata duhet te jete e vlefshme per periudhen e realizimit te kontrates.*

III.3.2. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.3.3. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1 pika 2 të LPP.

III.3.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi. Në rastin konkret, lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, i cili kundërshton shtojcën e bërë nga autoriteti kontraktor përse i përket paragrafit të shtuar “Ne rastin e pajisjeve që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën duhet te paraqese kontraten perkatese conform dispozitave te Kodit Civil ku te percaktohet disponueshmeria e pajisjeve dhe mjeteve te kerkuara per kryerjen e ketij sherbimi nga operatori ekonomik pjesmarres ne kete procedure. Kontrata duhet te jete e vlefshme per periudhen e realizimit te kontrates”, KPP gjykon se, ky përcaktim, është i paqartë dhe krijon konfuzion tek operatorët ekonomikë të cilët do të marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi. Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se

zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në rastin konkret synimi i autoritetit kontraktor është vërtetimi i kapacitetit të operatorit ekonomik në lidhje me pajisjet e kërkuara. Kriteret e kualifikimit duhet të jenë të qarta, të sakta dhe të mirëpërcaktuara nga autoriteti kontraktor me qëllim që të jenë sa më të kuptueshme jo vetëm për operatorët ekonomikë të interesuar për të qënë pjesëmarrës, komisionin e vlerësimit të ofertave në mënyrë të tillë që procesi i vlerësimit të mos kryhet me subjektivizëm, por të vendosë në situatë të barabartë edhe për personat me aftësi të kufizuar, duke mos penguar kështu pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi. Akoma më tej, në kriterin e mësipërm, autoriteti kontraktor ka përcaktuar qartë dokumentacionin që duhet të paraqitet nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës për vërtetimin e disponimit të pajisjeve (konkretisht: *Dokumenta që vertetojnë se keto mjete apo pajisje i ka në pronësi (të paraqitet fature blerje brenda vendit, ndërsa në rastet e blerjes jashtë vendit, faturat e blerjes të jenë të shoqëruar me dokument çdoganimi të tyre në emër të shoqërisë) ose për pajisjet dhe mjetet e marra me qira të paraqitet kontrata e qirase e cila duhet të jetë e vlefshme për periudhën e realizimit të kontratës*), kështu që rrjedhimisht, paragrafi i shtuar nga autoriteti kontraktor është i panevojshëm dhe konfuz.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Alstezo” sh.a. për modifikimin e kriterit “*Autoriteti kontraktor nuk mundet të kërkojë pajisje vetëm për gomat apo disqet e gomave pasi vetëm keto pajisje nuk mund të kryejnë shërbimet e riparimeve që janë përcaktuar nga vete Autoriteti kontraktor në DST të tilla siç janë linja e kontrollit dhe diagnostikimit të difekteve jo vetëm në motor (të rëndësishme si procese pune të shërbimeve të kërkuara nga AK në DST) linjë kjo e cila ka pajisje shumë të rëndësishme dhe pa të cilat nuk mund të kryhet riparimi dhe mirëmbajtja, kontrolli dhe diagnostikimi i gjendjes teknik xherike të mjeteve të kërkuara në DST para dhe pas riparimit. Konkretisht shërbimet në lidhje me kontrollin e sistemit të frenimit të mjetit, kontrolli në lidhje me sistemin e amortizimit të mjetit, kontrolli i sistemit të drejtimit të mjetit (xhokove etj) si edhe shërbime të tjera të përmendura dhe listuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit nuk mund të behen me pajisjet për gomat apo ballancimit të disqeve të gomave. Autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë kritere në përputhje dhe përpjesëtim me natyrën dhe permasat e kontratës objekt prokurimi dhe në përputhje me zerat e shërbimit të kërkuar rrjedhimisht duhet të përcaktojë edhe kriteret për pajisjet që një operator ekonomik disponon ose mund të disponojë në lidhje me kryerjen e këtij shërbimi me qëllim verifikimin nëse ky operator disponon të gjitha mjetet e duhura dhe të rëndësishme për kryerjen e një sere shërbimesh të domosdoshme në lidhje me mjetet që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentat e tenderit.*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.1. Në Shtojcën nr 2, të publikuar nga autoriteti kontraktor për modifikimin e dokumentave të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, pika 2.3.4 e “Kapacitetit teknik” është modifikuar si më poshtë:

ESHTE

2.3.4 Operatori ekonomik duhet te kete minimalisht, paisje teknike te nevojshme bashkekohore per realizimin e kontrates, si vijon:

- Jo me pak se 2 (dy) ura ngritese per automjete me kapacitet jo me pak se 3.5 ton
- Pajisje për kontrollin dhe testimin (diagnostikimin) e sistemit elektrik dhe difekteve në motorr të automjetit.
- Paisje per zmontimin dhe montimin e gomave ne diskun e rrotes se automjetit.
- Paisje per kontrollin&balancimin e disqeve&gomave automjetit (ballancimi rrotave).
- Paisje per kontrollin dhe realizimin e gjeometrise (konvergjences) rrotave te mjetit.
- Pajisje per kontrollin dhe mbushje me gaz te sistemit A/C

Ne lidhje me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese:

Dokumenta qe vertetojne se keto mjete apo pajisje i ka ne pronesi (te paraqitet fature blerje brenda vendit, ndersa ne rastet e blerjes jashte vendit, faturat e blerjes te jene te shoqeruar me dokument çdoganimi te tyre ne emer te shoqerise) ose per pajisjet dhe mjetet e marra me qira te paraqitet kontrata e qirase e cila duhet te jete e vlefshme per periudhen e realizimit te kontrates

BEHET

2.3.4 Operatori ekonomik duhet te kete minimalisht, paisje teknike te nevojshme bashkekohore per realizimin e kontrates, apo pajisje teknike që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën si vijon:

- Jo me pak se 2 (dy) ura ngritese per automjete me kapacitet jo me pak se 3.5 ton
- Pajisje për kontrollin dhe testimin (diagnostikimin) e sistemit elektrik dhe difekteve në motorr të automjetit.
- Paisje per zmontimin dhe montimin e gomave ne diskun e rrotes se automjetit.
- Paisje per kontrollin&balancimin e disqeve&gomave automjetit (ballancimi rrotave).
- Paisje per kontrollin dhe realizimin e gjeometrise (konvergjences) rrotave te mjetit.
- Pajisje per kontrollin dhe mbushje me gaz te sistemit A/C

Ne lidhje me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese:

☐ Dokumenta qe vertetojne se keto mjete apo pajisje i ka ne pronesi (te paraqitet fature blerje brenda vendit, ndersa ne rastet e blerjes jashte vendit, faturat e blerjes te jene te shoqeruar me dokument çdoganimi te tyre ne emer te shoqerise) ose per pajisjet dhe mjetet e marra me qira te paraqitet kontrata e qirase e cila duhet te jete e vlefshme per periudhen e realizimit te kontrates

☐ Ne rastin e pajisjeve që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën duhet te paraqese kontraten perkatese conform dispozitave te Kodit Civil ku te percaktohet disponueshmeria e pajisjeve dhe mjeteve te kerkuara per kryerjen e ketij sherbimi nga operatori ekonomik pjesmarres ne kete procedure. Kontrata duhet te jete e vlefshme per periudhen e realizimit te kontrates.

III.4.2. Në nenin 12 pika 1 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar parashikohet se: “Autoriteti kontraktor është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij”.

Në nenin 19/1 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar parashikohet se: “Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj”

Në nenin 63 pika 1 dhe 1.1 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar parashikohet se:

Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.

1.1 Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Në nenin 64 pika 3 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar parashikohet se:

Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë:

a) të nxjerrë një interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës;

b) të anulojë, plotësisht ose pjesërisht, një veprim ose vendim të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj;

c) të udhëzojë autoritetin kontraktor të korrigjojë shkeljet dhe më pas të vazhdojë me procedurën e prokurimit të kontratës;

ç) të urdhërojë anulimin e procedurave për shpalljen e kontratës fituese.

III.4.3. Në nenin 31 të Vendimit i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” parashikohet:

1. Komisioni, pas shqyrtimit administrativ të ankesës vendos me akt të motivuar:

.....

b) Ndalimin e autoritetit kontraktor të vazhdojë veprimet e paligjshme, duke i caktuar një afat kohor.

2. Nëse Komisioni vendos sipas pikës 1 shkronjës “b” të këtij neni me arsyetimin se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor është në kundërshtim me ligjin 9643/2006, dhe kontrata e prokurimit ende nuk është lidhur, atëherë Komisioni ka të drejtë:

....

b) Të anulojë plotësisht ose pjesërisht vendimin ose veprimin e autoritetit kontraktor të nxjerrë në kundërshtim me ligjin, si dhe të udhëzojë vazhdimin e procedurës së prokurimit në përputhje me ligjin, duke treguar veprimet që duhet të kryhen në vijim;

Në nenin 57 pika 2 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet se: “Njësisia e prokurimit është përgjegjëse për:

- sigurimin e të dhënave të nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion dhe përgatitjen e regjistrit të parashikimit dhe regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit publik;
- përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit (dhe justifikimin kur është rasti);
- përllogaritjen e fondit limit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme;
- hartimin e urdhrit të prokurimit;

- përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme që u bashkëlidhen atyre, përfshirë hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme;
- hartimin dhe dërgimin e njoftimeve për publikim, brenda afateve kohore;
- administrimin e të gjitha procesverbaleve për dokumentet e tenderit dhe çdo dokument tjetër, që lidhet me procedurat e përcaktimit të fituesit, duke përfshirë edhe procesverbalet e mbledhjeve, kur është rasti;
- llogaritjen e çmimeve të shitjes së dokumenteve të tenderit që u jepen operatorëve ekonomikë me kërkesë të tyre, kur është rasti.”

III.4.4. Referuar metodës së interpretimit sistematik (domethenjen e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik), Komsioni i Prokurimit Publik gjykon se ka një ndarje të qartë mes rolit të tij të paraparë nga ligji si organi më i lartë i shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimeve publike (neni 19/1 e vijues i LPP-së) dhe autoriteteve kontraktore si organ përgjegjës i zhvillimit të procedurave të prokurimit (neni 12 i LPP-së) dhe njëherazi përgjegjës për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik. Në nenin 63 pika 1.1. të LPP-së, parashikohet se “*Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik*”, pra kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar mekanizma ligjorë për kundërshtimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit pranë autoritetit kontraktor dhe më pas pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke dhënë garanci të plotë operatorëve ekonomikë ankimues. Në rastin konkret, KPP gjykon se njësia e prokurimit pranë autoritetit kontraktor ka parashikuar kriteret minimale kualifikuese, të gjykuar të nevojshëm për vërtetimin e plotësisht të kapacitetit teknik të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi. Kuadri ligjor në fuqi, ka paraparë pozitën juridike të Komisionit të Prokurimit Publik, si organ i shqyrtimit të ankesave kundër vendimeve të shprehura me akte administrative (dokumentet e procedurës së prokurimit) duke i dhënë të drejtën ligjore të shprehet mbi kriteret kualifikuese dhe specifikimet teknike në rast se këto të fundit janë hartuar në përputhje me ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, të ndryshuar dhe kuadrin ligjor sektorial në fuqi që rregullon kontratën objekt prokurimi. Kompetenca e mësipërme është shprehur në disa drejtime në ligjin për prokurimin publik në fuqi, ku nën nenin 63 pika 4 gërma “b” të *lex specialis* parashikohet se ndër kompetencat e Komisionit të Prokurimit Publik janë ato të *anulimit, plotësisht ose pjesërisht, një veprimi ose vendimi të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj.* Në rastin konkret, KPP gjykon se objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimues nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor (verifikimin ligjor në rast se kriteret kualifikuese janë në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës, apo në rast se specifikimet teknike janë hartuar në formën e kërkuar nga ligji), por mbi shtimin e kriterëve kualifikuese në një procedurë prokurimi. Sa më sipër, KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar se është në të drejtën e plotë të autoritetit kontraktor të parashikojë kriteret minimale kualifikuese në një procedurë prokurimi dhe në rast se këto të fundit, (vetëm kriteret e shprehura dhe jo ato hipotetike të kërkuara) nuk janë në përputhje

me rregullimet ligjore në fuqi, jepet garancia procedurale e paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Sa më sipër, përsa kohë që autoriteti kontraktor ka parashikuar si të nevojshme për kryerjen e shërbimit një numër minimal pajisjesh, KPP në asnjë rast nuk mund të marrë kompetencat e autoritetit kontraktor (njësisë së prokurimit) të shtojë kritere të tjera kualifikuese për marrjen pjesë në procedurat e prokurimit publik.

Sa më sipër, pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se "... Me modifikimin e publikuar ne datën 25.07.2019 autoriteti kontraktor ka shtuar edhe kriterin: "Stafi i sipercituar duhe te kene eksperience minimalisht 3 muaj pune ne profesionet perkatese te sipercituara vertetuar me dokumentacion te leshuar nga institucionet e autorizuar me ligj." Ky shtim kriteri eshte i paqarte i pakuptimte dhe nuk kuptojme qellimin e AK pse e ka vendosur. AK kerkon qe stafi te kete eksperience minimalist 3 muaj pune ne profesionet perkatese dhe kerkon te vertetohet kjo me dokumentacion te leshuar nga institucionet e autorizuar me ligj. Ky percaktim eshte kontradiktor dhe i paqarte sepse AK nuk ka percaktuar se kush jane institucionet e autorizuar me ligj qe leshojne nje dokument te tille per profesionet me lart apo per eksperiencen 3 mujore qe ka kerkuar AK, per me teper qe duket nje kriter i teper e pa sens logjik. Ak per te vertetuar kapacitetet ne lidhje me stafin duhet te mjaftohet me listepagesat ku punonjesit me profesionet perkatese te jene te perfshire si edhe me kontratat e punes, si dhe deshmite profesionale te punonjesve. Kerkesa e shtuar ne modifikim eshte e teper, diskriminuese, jo ne perpjesetim me objektin dhe natyren e prokurimit dhe si sherben aspak qellimit te AK per vertetimin e disponimit te kapaciteteve nga ana e OE. [...] Si përfundim kerkojme heqjen e ketij percaktimi si diskriminues e përjashtues, te tepert e te pakuptimte, duke kufizuar konkurrencën dhe pjesëmarrjen ne procedure e prokurimit, ose modifikimin dhe riformulimin e tij në përputhje me LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik. [...]", Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.5.1. Në Shtojcën nr 2, të publikuar nga autoriteti kontraktor për modifikimin e dokumentave të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, është përcaktuar kriteri:

"Ne shtojcen nr. 7 "Kriteret e vecanta të kualifikimit" Kriteret e vecanta te kualifikimit nen titullin Per kapacitetin teknik: pika 2.3.1

ESHTE

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete ne stafin e tij te punesuar te perhershëm ose me kontrate jo me pak se 5 (pesë) punonjes mesatarisht per çdo muaj per periudhen Mars 2019 - Maj 2019, nga të cilet ne stafin teknik te jene te punesuar përgjegjës in teknik/drejtuesi teknik, i cili duhet të jetë inxhinier mekanik ose teknik, mekanik transporti, 1 (nje) pompist ose motorrist, 2 (dy) xhenerikë, 1 (nje) elektroaut.

Ne lidhje me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese:

Listepagesat e sigurimeve shoqerore per periudhen (Mars 2019 - Maj 2019) ku punonjesit me profesionet perkatese sa me siper te jene te pasqyruar perkatesisht ne keto lista si dhe kontratat e punes.

BEHET

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të punësuar të përhershëm ose me kontratë jo më pak se 5 (pesë) punonjës mesatarisht për çdo muaj për periudhën Mars 2019 - Maj 2019, nga të cilët në stafin teknik të jenë të punësuar përgjegjësin teknik/drejtuari teknik, i cili duhet të jetë inxhinier mekanik ose teknik, mekanik transporti, 1 (një) pompist ose motorrist, 2 (dy) xhenerikë, 1 (një) elektroaut

Ne lidhje me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

Listëpagesat e sigurimeve shoqërore për periudhën (Mars 2019 - Maj 2019) ku punonjësit me profesionet përkatëse sa më sipër të jenë të pasqyruar përkatësisht në këtë listë si dhe kontratat e punës.

Stafi i sipërcituar duhet të ketë eksperiencë minimalisht 3 muaj pune në profesionet përkatëse të sipërcituara vërtetuar me dokumentacion të lëshuar nga institucionet e autorizuar me ligj.”

III.5.2. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për të njohur gjendjen e operatorëve ekonomikë, kapacitetet ekonomike, financiare, teknike e ligjore, me qëllim realizimin me sukses të kontratës, dhe nga ana tjetër përcaktimi dhe vendosja e kriterëve duhet të bëhet në përpjesëtim dhe në proporcion me natyrën dhe objektin e prokurimit. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, mbi modifikimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit për procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementëve kryesorë. Së pari nëse kërkesa në fjalë është të përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Gjithashtu, në shqyrtimin e kriterit të mësipërm të kualifikimit, K.P.P. gjykon të ndalet edhe në faktin në rast se kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së.

III.5.3. Nga shqyrtimi i kriterit të mësipërm, konstatohet se, autoriteti kontraktor kërkon që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të kenë në stafin e tyre të punësuar, të përhershëm ose me kontratë, jo më pak se 5 (pesë) punonjës mesatarisht për çdo muaj për periudhën Mars 2019 - Maj 2019, të cilët duhet të jenë një përgjegjës teknik/drejtuari teknik, i cili duhet të jetë inxhinier mekanik ose teknik, mekanik transporti, 1 (një) pompist ose motorrist, 2 (dy) xhenerikë dhe 1 (një) elektroaut. Për këta punonjës, operatori ekonomik duhet të paraqesë listëpagesat e sigurimeve shoqërore për periudhën (Mars 2019 - Maj 2019), ku punonjësit me profesionet përkatëse sa më sipër, të jenë të pasqyruar përkatësisht në këtë listë, si dhe kontratat e punës për këta punonjës. Me modifikimin e këtij kriteri, autoriteti kontraktor ka shtuar gjithashtu kërkesën se stafi i sipërcituar duhet të ketë eksperiencë minimalisht 3 muaj pune në profesionet përkatëse të sipërcituara, vërtetuar me dokumentacion të lëshuar nga institucionet e autorizuar me ligj.

Sa më sipër, nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, si dhe nga shqyrtimi i kriterit të mësipërm, KPP gjykon se, kërkesa e shtuar nga autoriteti kontraktor në shtojcën për modifikimin e dokumentave të tenderit, se stafi i sipërcituar duhet të ketë eksperiencë minimalisht 3 muaj pune në profesionet përkatëse të sipërcituara vërtetuar me dokumentacion të lëshuar nga institucionet e autorizuar me ligj, është një kërkesë e ekzagjeruar dhe e cila krijon konfuzion tek operatorët ekonomikë të cilët do të marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi. Gjithashtu, KPP sqaron se, për sa kohë, autoriteti kontraktor në lidhje me punonjësit e mësipërm, ka kërkuar që të paraqiten listëpagesat e sigurimeve shoqërore për periudhën (Mars 2019 - Maj 2019), ku punonjësit me profesionet përkatëse sa më sipër të jenë të pasqyruar përkatësisht në këtë listë, si dhe kontratat e

punës për këta punonjës, pra nëpërmjet dokumentacionit të mësipërm, arrin të vërtetojë eksperiencën e mëparshme e nevojshme për këta punonjës si dhe profesionet e tyre, rrjedhimisht kërkesa se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacion të lëshuar nga institucionet e autorizuar me ligj për vërtetimin e eksperiencës së punonjësve për 3 muaj punë në profesionet përkatëse është një kërkesë e përsëritur dhe e panevojshme, e cila krijon konfuzion tek operatorët ekonomikë, dhe si tillë duhet të hiqet.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Alstezo” sh.a. për procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-30470-07-16-2019, me objekt “Riparim dhe mirembajtje automjete”, me fond limit 2.499.500 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 12.08.2019, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal, Fier.
 2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
 4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Alstezo” sh.a.
 5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1362 Protokolli,

Datë 05.08.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha